Konflikt i interesit është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejpërdrejtë ose të tërthortë që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësive të tij publike.

| |
|---|
| Në zbatim të nenit 21 pika 1 e Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve përcaktuar në Kreun III, Seksioni II, që iu ndalohet në mënyrë absolute të përfitojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nga lidhja e kontratave me një palë një institucion publik janë: |
| - Presidenti i Republikës, Kryeministri, zvkryeministri, ministrat, ose zvministrat, Deputetet, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët e Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë e në atë të Apelit, Avokati i Popullit, Anëtari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Anëtarët e Enteve Rregullatore, (Këshilli i Mbikqyrjes i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zv/Guvernatorin; të konkurrencës, telekomunikacionit; energjisë; furnizimit me ujë; të sigurimeve; letrave me vlerë; mediave), Sekretarët e Përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar tjetër, në çdo institucion publik, që është të paktën i barazvlefshëm për nga pozicioni me drejtorët e përgjithshëm, titullarët e institucioneve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.<br><br>Për zyrtarët e nivelit të mesëm drejtues sipas nenit 31, dhe për zyrtarët e parashikuar në nenin 32 të kreut të III, seksioni 2 të këtj ligji, ndalimi sipas pikës 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave në fushën e territorit dhe të juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë është një institucion i varësisë. |
| Kur zyrtari është në funksionin e kryetarit a të nënkryetarit të bashkisë, komunës ose të këshillit të qarkut, të anëtarit të këshillit përkatës ose është zyrtar i nivelit të lartë drejtues të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave privatë të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë, zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave, sipas rastit, me bashkinë, komunën ose këshillin e qarkut, ku zyrtari ushtron këto funksione. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë në kontratë është një institucion publik, në varësi të kësaj njësie (neni 21 pika 2 e Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005). |

Ndalimet e përcaktuara në nenin 21 pika 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin që në kuptim të këtij ligji janë **bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi, fëmijë në moshë madhorë, prindërit e zyrtarit të bashkëshortit/es dhe bashkëjetuesit/es.**

Unë i nënshkruari ____________________, me cilësinë e përfaqësuesit të personit juridik _______________deklaroj nën përgjegjësinë time personale se:

Jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të përcaktuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike" i ndryshuar, si dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive si dhe të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Në përputhje me to deklaroj se asnjë zyrtar i përcaktuar në **Kreun III, Seksioni II** te Ligjit Nr. 9367, datë 7.4.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk zotëron interesa private në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me personin juridik që unë përfaqësoj.

Data e dorëzimit të deklaratës ________________

**Emri, Mbiemri, Nënshkrimi**

**____________________________**

Vula

**Shtojca 9**

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik*]

**DEKLARATË**
**Mbi disponueshmërinë e anëtarit tëstafit tëkonsulentit[3]**

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë ________________ nga Autoriteti Kontraktor________________ me objekt ____________ me fond limit __________.

Në bazë të parashikimeve të neneve 28 dhe37tëVKMNr. 914, datë 29.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", të ndryshuar, Unë i nënshkruari ____________________, në cilësinë e anëtarit të stafit të Konsulentit "............................................" për procedurën e prokurimit me objekt______________ nën përgjegjësinë time personale, ***Deklaroj***se:

1. Autorizoj VETËM Konsulentin "…………………………………..'' të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë ________________ nga Autoriteti Kontraktor________________ me objekt ____________ me fond limit __________.

Deklarimi i personit tim, si anëtaristafit nga ana e çdo konsulenti tjetër, për procedurën e prokurimit me objekt ……………………………………………………., është i pamiratuar dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor.

3. Nuk ndodhem në kushtet e konfliktit të interesit, ***me asnjë*** nga anëtarët e stafit të autoritetit kontraktor, drejtpërdrejtë ose jo, i përfshirë në ndonjë pjesë të përgatitjes së kushteve të kontratës dhe/ose në procesin e përzgjedhjes për këtë kontratë dhe/ose për mbikëqyrjen e kësaj kontrate.

Data e dorëzimit të deklaratës ________________

**Emri, Mbiemri, Nënshkrimi**

Vula

**Shtojca 10**

[ *Shtojce per tu plotesuar nga Autoriteti Kontraktor*]

[3]Kjo deklaratë duhet të nënshkruhet nga seicili prej anëtarëve të stafit të konsulentit dhe do të jetë pjesë e dokumentave të ofertës së konsulentit.

## 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 "Për Organizatat jo Fitimprurëse".
b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

**Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.**

**Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 11.**

**Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, seicili prej anëtarëve të bashkimit duhet të dorëzojë vetdeklarimet, sipas kësaj Shtojce.**

**Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.**

**Vec kesaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë,duhet te dorezohen:**

**a.**Marrëveshja e noterizuar, sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht[4];

**b.** Prokura e posaçme.

## 2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

*a. Sigurimin e Ofertës (nese eshte e zbatueshme) sipas Shtojcës 6;*

[4]Në këtë marrëveshje nuk duhet të përcaktohet përqindja e sherbimeve të seicilit anëtar, por fushat/ekpertizat e marra përsipër për tu realizuar.

*b Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit, sipas Shtojcës 8;*
*c. Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit të konsulentit, sipas Shtojcës 9;*
*ç. Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*
d. *Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojces 11/1:*

2. Kandidati/ofertuesi duhet tëdorëzojë:

**2.1 Kapaciteti Ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:**

Plotësimi i kapaciteteve ligjore nga operatorët ekonomikë dhe vërtetimi se ata kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi, bëhet me anë të paraqitjes prej tyre të deklaratës mbi përmbushjen e kritereve të përgjithshme, sipas shtojcës 11.

**2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**
Persa i perket kapacitetit ekonomik dhe financiare, kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat minimale:

**1.Taksat vendore:** Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin, 2019 sipas Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për *sistemin e taksave vendore*" (i ndryshuar) dhe VKB Nr. 28, datë 24.03.2020 "Për krijimin e lehtësirave fiskale ndaj biznesit dhe shtyrjen e afateve te aplikimit për programet sociale të strehimit në kuadër të masave për parandalimin e përhapjes së infeksionit Covid-19".

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Njësia Administrative ose Bashkia në të cilën është regjistruar sipas QKR).

**2.Bilanci:** Referuar Aktit Normativ nr. 10, datë 26.03.2020, të publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 52, datë 26.03.2020, ku parashikohet ndër të tjera shtyrja e afatit për dorëzimin e bilanceve për vitin 2019, deri në 31 **Korrik të vitit 2020**. OE duhet të paraqesë kopje të çertifikuara të bilanceve të 2 (dy) viteve të fundit ushtrimore (**2017, 2018**) të paraqitura në autoritet përkatëse përkatëse Dega e Tatim Taksave, të konfirmuara nga ky autoritet.

3. **Xhiro:** Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim nga Administrata Tatimore/Vërtetim të gjeneruar dhe vulosur me anë të një proçedure automatike nga një sistem elektronik për xhiron mesatare vjetore të realizuar gjatë dy viteve të fundit financiare (**2018, 2019**) nga data e zhvillimit te tenderit lëshuar nga autoriteti përkatës, e cila duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht**24,127,159.6 (**njëzet e katër milion e njëqind e njëzet shtatë mijë e njëqind e pesëdhjetë e nëntë presje gjashtë**) lekë pa tvsh**

**2.3 Kapaciteti teknik:**

**Përvojë e suksesshme në ekzekutimin e të paktën:**

Shërbime të ngjashme të realizuara gjatë tre viteve të fundit, nga data e zhvillimit te tenderit, me një vlerë ***jo më të vogël se*** 40% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht **24,127,159.6 (**njëzet e katër milion e njëqind e njëzet shtatë mijë e njëqind e pesëdhjetë e nëntë presje gjashtë**) lekë pa tvsh.**

**a.**Kur shërbimi i ngjashëm është realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta

vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur kontratën përkatëse, vërtetim për realizimin e plotë dhe te suksesshëm të kesaj kontrate.

**b.**Kur shërbimi i ngjashëm është realizuar me subjekte private, Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur faturat tatimore perkatese, ku *shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.*

**3.Liçensa profesionale lidhur me shërbimet objekt i kontratës**:

**Liçensa profesionale të shoqërisë ( e vlefshme) për projektim (leshuar nga MZHUT ose nga Institucioni i Autorizuar sipas legjslacionit në fuqi për dhënien e licensave profesionale në fushën e studimit e projektimit në ndërtim), ku të përfshihen kategorite:**

- *2b (qendra tregatre ,objekt social-kulturore,objekte kulti ,objekte arsimore):*
- *2c (Projektim interiere)*
- *2d (Projektim peisazhi, sistemim siperfaqe te gjelberta, lulishte e parqe)*
- *3a(objekte civile industriale turistike prej murature e skelet beton arme deri ne 5 kate)*
- *3c\1objekte me shkalle te larte veshtiresie beton arme -metalike*

- 4\a- Projektim të instalimeve hidro-termosanitare.
- 4\b- Projektim të instalimeve termoteknike-kondicionimi, si dhe të impianteve të prodhimit të energjisë termike nga burime të rinovueshme.
- 4\c- Projektim të linjave e rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale.
- 4\d- Projektim të sistemeve komplekse të telekomunikacionit.
- 4\f- Projektim të sistemeve kundra zjarrit.
- 4\g- Projektim të sistemeve të monitorimit dhe automatizimit në industri dhe ndërtesa.
- 4\h- Projektimi i impianteve ngritëse e transportuese (ashensorë, shkallë lëvizëse etj.).
- 4\i- Projektimi i ndriçimit rrugor, shesheve, dekorativ, ndriçimit të objekteve të mëdha sportive, porteve aeroporteve etj.
- j- Projektim të rrjeteve të telefonisë, citofonisë, fonisë, internetit, TV, access controll, CCTV, sistemet e alarmit, sistemet e dedektimit të zjarrit etj., për objektet civile e industriale.
- 5 b*) Furnizim me ujë – kolektorë shkarkimi*
- 8/a*(Rivelime inxhinierike.)*
- 8 c) Sisteme GIS
- 9/a *( Studim/Vlerësim gjeologo-inxhinierik i truallit për objektet civile – ekonomike deri* 5 *kate)*
- 10/e*( Kabina elektrike të rrjetit shpërndarës – linja të tensionit të ulët- mesëm.*

*(Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i liçencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës).*

*Sqarim: Për licencat e lëshuara pas hyrjes në fuqi të Vendimit nr.943, datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave ‘Për licencimin professional të individëve dhe personave juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në*

*ndërtim", Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë* **Liçensa profesionale të shoqërisë (e vlefshme) për projektim (leshuar nga MZHUT** ose institucione të tjera të autorizuara sipas legjislacionit në fuqi për dhënien e liçensave profesionale në fushën e studim projektimit në ndërtim**)***, e vlefshme, ku të përfshihen kategoritë e mësipërme me ndryshimet përkatëse në emërtesë.*

**3.1 Operatori ekonomik duhet te paraqese Licencat profesionale te stafit kryesor përgjegjës për zbatimin e kontratës ne kategorite si me poshte shenuar, kontratat individuale te punes (të vlefshme), diplome, CV, dhe stafi i mëposhtëm :**

- ***2 ( dy )PROJEKTUES ARKITEKT*** *Kat 2b (qendra tregatre ,objekt social-kulturore,objekte kulti ,objekte arsimore): 2c (Projektim interiere) 2d (Projektim peisazhi, sistemim siperfaqe te gjelberta, lulishte e parqe)*
- ***1 (një) PROJEKTUES KONSTRUKTOR*** *3a(objekte civile industriale turistike prej murature e skelet beton arme deri ne 5 kate)3c\1objekte me shkalle te larte veshtiresie beton arme -metalike*

- ***1 (një) PROJEKTUES INSTALATOR***4\a- Projektim të instalimeve hidro-termosanitare. 4\b- Projektim të instalimeve termoteknike-kondicionimi, si dhe të impianteve të prodhimit të energjisë termike nga burime të rinovueshme. 4\c- Projektim të linjave e rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale. 4\d- Projektim të sistemeve komplekse të telekomunikacionit. 4\f- Projektim të sistemeve kundra zjarrit. 4\g- Projektim të sistemeve të monitorimit dhe automatizimit në industri dhe ndërtesa. 4\h- Projektimi i impianteve ngritëse e transportuese (ashensorë, shkallë lëvizëse etj.). **4\i-** Projektimi i ndriçimit rrugor, shesheve, dekorativ, ndriçimit të objekteve të mëdha sportive, porteve aeroporteve etj.*4*\j- Projektim të rrjeteve të telefonisë, citofonisë, fonisë, internetit, TV, access controll, CCTV, sistemet e alarmit, sistemet e dedektimit të zjarrit etj., për objektet civile e industriale.
- ***1 (një) PROJEKTUES VEPRA HIDRAULIKE*** *Kat* *5/b*- Furnizim me ujë – kolektorë shkarkimi

- ***1 (një) PROJEKTUES GJEODET Kat 8****. a) Rilevime inxhinierike*8 c) Sisteme GIS.

- ***1 (një)*** **GJEOLOG/HIDROGJEOLOG** Kat 9 a) Studim/vlerësim gjeologo-inxhinierik i truallit për objekte civile - ekonomike deri 5 kate

- ***1 (një)*** **PROJEKTUES I IMPIANTEVE TË PRODHIMIT DHE SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE, kat** 10/e*( Kabina elektrike të rrjetit shpërndarës – linja të tensionit të ulët- mesëm.*

***Një projektues nuk duhet të jetë i angazhuar njëkohësisht në stafin e dy shoqërive që marrin pjesë në procedurën e prokurimit.***

**4.** Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar në stafin e shoqërisë së tij:

- 1 (një) *Ekspert* për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis.

Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit të sipërcituar operatori ekonomik duhet të paraqesë diplomën, kontratën individuale të punës ( të vlefshme), si dhe çertifikatën për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis.

**5**. Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar në stafin e shoqërisë së tij:

- 1 (një) *Ekspert* për mbrojtjen nga zjarri.

Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit të sipërcituar operatori ekonomik duhet të paraqesë diplomën, kontratën individuale të punës ( të vlefshme), si dhe çertifikatën për mbrojtjen nga zjarri.

**6**.Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar në stafin e shoqërisë së tij:

- 1 (një) *Ekspert*Inxhinier – Auditues energjie

Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit të sipërcituar operatori ekonomik duhet të paraqesë diplomën, kontratën individuale të punës ( të vlefshme), si dhe Certifikata (Dip) per auditimin e energjise).

**7.** Operatori Ekonomik duhet të ketë punësuar në stafin e shoqërisë së tij 1 (një) **ekspert akustike.** Eksperti i akustikës duhet te kete eksperience ne projektimin e objekteve social – kulturore si teatro etj...

**8.**Operatori Ekonomik duhet të ketë punësuar në stafin e shoqërisë së tij 1 (një) **ekspert ndriçimi.** Eksperti i ndriçimit duhet te kete eksperience ne projektimin e objekteve social – kulturore si teatro etj....

**9**. CV e Operatorit Ekonomik - nje pershkrim i pergjithshem i profilit te veprimtarise, te dhena te pergjithshme lidhur me eksperienca dhe bashkepunime, ne permbushje te projekteve te ndryshme me natyre konsulence, ne fushen e projektimit te godinave social – kulturore.

**10.**Një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit, shoqeruar me diplomat, CV-të e tyre, licencat profesionale (kur kanë të tilla) dhe marreveshjet e bashkepunimit, kontratat perkatese te punes ose te nenkonsulences ne rast se ky staf nuk eshte pjese e shoqerise. Stafi kryesor per hartimin e projektit duhet te kete nje pervoje pune minimumi 10 vjet ne fushen e projektimit per sherbime te ngjashme.

***Ne rast kur Operatori Ekonomik/Bashkimi Operatoreve angazhojne edhe staf te huaj per zbatimin e kontrates, ekspertet e huaj duhet te jene te pajisur me nje License/Certifikate ekuivalente ne shtetin e tyre te origjines per kryerjen e sherbimeve objekt te kesaj kontrate dhe te paraqesin CV-te e tyre.***

**11. Një punësim mesatar i të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) personave për periudhën Nëntor 2019 - Maj 2020 të vërtetuar me;**

- Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj per periudhen Nëntor 2019 - Maj 2020.

- Listpagesat e punonjesve te konfirmuara nga autoritetet perkatese sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi per periudhen Nëntor 2019 - Maj 2020

**12.Operatoret Ekonomik** duhet te paraqesin ne baze te Udhezimit te agjensise se prokurimit publik dt 25.07.2017 nje analize te cmimit të paraqitur, duke specifikuar sakte të gjithë elementet që kanë marrë parasysh në llogaritjen e cmimit, si dhe duke plotesuar të gjitha kerkesat e VKM 354 date 11.05.2016 si dhe aktet ligjore ne fuqi.

**13.** Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një çertificate **ISO 9001 -2015 (**e vlefshme) për menaxhimin e cilësisë lëshuar nga institucione të akredituara për këtë qëllim. (Në rastet e Bashkimit te Operatoreve ekonomik çdo anëtar i grupit duhet të paraqese certifikatën e mësipërme në bazë të zërave të marrë përsipër të realizoje sipas marrëveshjes së bashkëpunimit)

**14.**Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një çertificate **ISO 14001-2015**(e vlefshme, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë).(Në rastet e Bashkimit te Operatoreve ekonomik çdo anëtar i grupit duhet të paraqese certifikatën e mësipërme në bazë të zërave të marrë përsipër të realizoje sipas marrëveshjes së bashkëpunimit)

**15.** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Çertifikatë/OHSAS **18001-2007**, ekuivalente **ISO 45001-2018** (e vlefshme) lëshuar nga institucione të akredituara për këtë qëllim (Në rastet e Bashkimit te Operatoreve ekonomik çdo anëtar i grupit duhet të paraqese certifikatën e mësipërme në bazë të zërave të marrë përsipër të realizoje sipas marrëveshjes së bashkëpunimit)

**Në rastet e bashkimit të konsulentëve, kriteret e veçanta të kualifikimit plotësohen bashkarisht nga i gjithë bashkimi.**

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

**Shtojca 11**

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik*]

**DEKLARATË MBI PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME**

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesemarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë_______________ nga Autoriteti Kontraktor ___________ me objekt ___________________me fond limit __________.

Unë i nënshkruari __________________me cilesinë ___________të operatorit ekonomik ___________________ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Operatori ekonomik ______________________është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 "Për Organizatat jo Fitimprurëse".

- Operatori ekonomik ____________________ nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara Nenin 45/1 të LPP.

- Personi/at në cilësinë e ***anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik,***si më poshtë:

  ______________________

  ______________________

  ______________________etj.

  nuk janë ose kanë qenë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në nenin 45/1 të LPP[5].

- Operatori ekonomik ____________________ nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

- Operatori ekonomik ____________________ nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

- Operatori ekonomik ____________________ ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

**Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomiksi më sipër.**

**Data e dorëzimit të deklaratës _____________**

**Nënshkrimi i ofertuesit ______________**

**Vula** ______________

[5] Autorizoj Autoritetin Kontraktor të bëjë verifikimet përkatëse të gjendjes gjyqësore të personave të deklaruar në këtë Deklaratë

**Shtojca 11/1**

[ *Shtojcë për t’u plotësuar nga Operatori Ekonomik*]

**DEKLARATË MBI GARANTIMIN E ZBATUESHMËRISË SË DISPOZITAVE LIGJORE NË MARRËDHËNIET E PUNËS**

Deklaratë e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës në proçedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë _______________ nga Autoriteti Kontraktor ___________ me objekt _______________me fond limit __________.

Unë i nënshkruari __________________me cilësinë e ___________të operatorit ekonomik __________________, **deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:**

- Operatori ekonomik ________________________garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i

punës në fuqi.

- Operatori ekonomik___________________lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.

- Operatori ekonomik ________________nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Nërastet kur janë konstatuar shkelje ligjore,operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.

**Data e dorëzimit të deklaratës _____________**
**Përfaqësuesi i ofertuesit**
**Nënshkrimi**
**Vula**

**Shtojca 12**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*]

## SPECIFIKIMET TEKNIKE

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

**Shtojca 13**

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në marrëveshjen kuadër]

## PLANIFIKIMI I KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR

| Shërbim:<br>Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes Kuadër _____ | | |
|---|---|---|
| **Kontrata Nr.** | **Titulli i Kontratës** | **Përshkrim i shkurtër i kontratës** |
| **01** | __________ | _______________ |
| **02** | __________ | _______________ |
| **03** | __________ | _______________ |
| **…** | __________ | _______________ |

**Shtojca 14**

( *Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)*

*(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit*)

## SHËRBIMET DHE GRAFIKU I EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet:

Afatet e ekzekutimit:

**Shtojca 15**

**Studim-Projektim " Ndërtim i Teatrit Kombëtar"**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*]

**TERMAT E REFERENCËS**

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:**Studim-Projektim " Ndërtim i Teatrit Kombëtar"**

Detyrat:

**DETYRË PROJEKTIMI**

**PËR REALIZIMIN E STUDIM-PROJEKTIMIT:**

**NDËRTIM I TEATRIT KOMBËTAR**

Bashkia e Tiranës, në zbatim të VKM Nr. 377, Datë 8.5.2020 "Për kalimin në pronësi të Bashkisë Tiranë" të pasurisës nr.1/241, me emërtimin "Teatri Kombëtar", në Z.K. 8150, Tiranë, kërkon të realizojë studim - projektim për objektin: "Ndërtim i Teatrit Kombëtar" në qytetin e Tiranës.

1. Të dhëna dhe kërkesa të përgjithshme

Kjo godinë e re e aktrimit dhe shfaqjeve teatrale duhet të konceptohet si zemra kulturore e Tiranës e dedikuar për artin e të aktruarit. Funksioni kryesor i godinës së teatrit është t'u plotësojë spektatorëve komoditetin dhe kushtet optimale për perceptimin e mirë të shfaqjes teatrale, ndërsa artistëve t'u plotësojë kushtet për pregatitjen dhe shfaqjen e pjesës teatrale. Godina e teatrit ka dy pjesë : grupin e ambjenteve për spektatorët dhe grupin e kthinave për aktorët. Në teatrot e sotëm hapësira e sallës së shfaqjeve me kthinat ndihmëse zë afërsisht 40 % të vëllimit të përgjithshëm të godinës së teatrit ndërsa hapësira e skenës me kthinat ndihmëse zë rreth 60 %. Projekti duhet të ofrojë të gjitha kushtet e nevojshme për zhvillimin e aktrimit dhe komoditetin e spektatorëve.

Objekti i studim-projektimit:
Ndërtimi i godinës së re të "Teatrit Kombëtar" propozohet për ndërtim në truallin ekzistues, sipas të gjitha standarteve kombëtare dhe ndërkombëtare të projektimit të objekteve të ngjashme.

2. Kërkesa projektimi të përgjithshme
Në arkitekturën e godinës së teatrit duhet të pasqyrohet jo vetëm koncepti bazë i të projektuarit sipas standarteve por edhe kërkesat urbanistike- arkitektonike të vendit tonë si dhe arkitektura

me materialet bashkëkohore. Arkitektura e jashtme e teatrit përcaktohet para së gjithash nga ndërtimi vëllimor i tij, në të cilën duhet të jetë pasqyruar përmbajtja e brëndshme , struktura e godinës dhe rëndësia urbanistike. Sallat e mëdha të teatrit që përbëjnë bazën kompozicionale të godinës duhet të shprehen qartë në formën e tij të jashtme duke u bërë kështu elementi kryesor formulues i fasadës. Ndërtimi logjik dhe i lirë i volumeve të godinës, përpjestimet e tyre dhe lidhja organike me sheshin e ndërtimit janë drejtimet kryesore sipas të cilave duhet të zhvillohet arkitektura e godinës së teatrit. Arkitektura duke plotësuar kërkesat funksionale duhet të plotësojë njëkohësisht edhe kërkesat estetike, prandaj zgjidhja e interierit të sallës së shfaqjeve si ambjent i brëndshëm hapësinor duhet ti plotësojë të dyja këto kërkesa.

2.1 Tipi i teatrit në lidhje me numrin e komunitetit

Përmasa dhe tipologjia e teatrit duhet të përcaktohet nga numri i popullsisë për të cilin ndërtohet:
Komunitet me a. 50.000 banorë 500-600 vendë (teatër)
b. 50- 100.000 banorë 600-700 vendë (teatër-opera)
c. 200- 500.000 banorë 700-800 vendë (teatër trivalent)
d. 500.000 – 1.000.000 banorë 1000-1400 vende (teatër opera)
dhe 800 vende (teatër prozë) + teatro studio të vegjël
e më shume se 1.000.000 banorë 1400-2000 vende (teatër opera ) , 800 -1000 vende (teatër prozë) + një numër i madh teatrosh të vegjël eksperimentalë

2.2 Zonimi funksional i teatrit

Gjatë projektimit të këtij objekti duhet të krijohet një bilanc mes cilësisë së funksionimit dhe efikasitetit të kostos. Projektuesi duhet të ketë parasysh që:

- Zonat e përshtatura të qarkullimit: hapësirat e qarkullimit nuk duhet të kalojnë 25% të sipërfaqes së dobishme të ndërtuar. Ato duhet të jenë funksionale dhe të respektojnë kërkesat për siguri;
- Numri optimal i hapësirave: numri i hapësirave fillimisht përcaktohet sipas shfrytëzimit.
- Përshtatshmëri maksimale: hapësirat duhet të projektohen me një përshtatshmëri maksimale, që i mundëson ato të përshtaten për lëndë dhe ndryshime të ndryshme, në ato raste kur kjo përshtatet me kërkesat e tyre funksionale;
- Grupimi i hapësirave: hapësirat duhet të grupohen në blloqe sipas funksionit dhe ndërlidhjes. Kjo do të siguronte një identifikim të lehtë të veprimtarive dhe hapësirave të tyre korresponduese, një komunikim të lehtë mes hapësirave të ndryshme, pa pengesa nëpër zonat e qarkullimit dhe ato të pritjes, një vëzhgim të lehtë të hapësirave dhe një shfrytëzim optimal të tokës në dispozicion;
- Integrimi i nevojave: lokacioni i hapësirave brenda qendrës duhet të ndjekë domosdoshmëritë themelore siç janë rregullat e sanitarisë dhe higjienës, rregulloret e komoditetit funksional dhe të sigurisë, si dhe komoditetin akustik, vizual e atë klimatik.

2.3 Zonimi përbëhet nga:

1. Zona e shfaqjes dhe e përgatitjes së saj e cila përbëhet nga hapësira e skenës (skena, prapaskena, paraskena dhe gropa e orkestrës)
2. Zona e spektatorëve
3. Zona e pushimit
4. Kabina e kontrollit (regjia)
5. Zona e provave dhe e laboratorëve

6. Zona e administratës
7. Zona komunikuese, hyrjet, shkallët, korridoret, hollet
8. Sallat black box
9. Ambjent për menaxhimin e situatave të emergjencës.
10. Hapësirat ndihmëse (ambjentet sanitare)
11. Hapësira e shërbimeve etj, kjo duhet të përfshijë:

- dhomat e artistëve
- dhomat e solistëve
- dhoma provash
- magazine për vendosjen e materialeve të skenës
- ambjentet e mbrojtjes kundër zjarrit
- dhomat e trukimit dhe parukerisë
- locale për makineritë
- biletaria
- magazinim (skenografi, kostume, paruke, këpucë, materiale elektrike, instrumenta muzikore, rekuizit etj…)

2.3.1 Përmasat e mundshme të skenës dhe bokaskenës

Referuar standarteve dhe manualeve në fuqi kombëtare dhe ndërkombëtare.

Pjesët përbërëse të skënës

- Ashensori I skenës ballore & Karrigja Vagon (të lëvizshme)

Ashensori i orkestrës është i pozicionuar në cep të skenës. Ai lëviz ndërmjet nivelit të skenës dhe pozicionit të karrigeve vagon në nivelin e podrumit. Kjo hapësirë mund të kthehet në një skenë të dalë përpara, në një dysheme të sheshtë ose vende për tu ulur në nivelin e auditorit. Ashensori i orkestrës ka kapacitet për të shtuar vende dhe për tu ulur duke përdorur një set me karrige vagonë (të lëvizshme).

- Perdja e Sigurisë në Paraskenë

Perdja e Sigurisë në paraskenë përdoret për të vulosur hapjen midis Skenës dhe auditorit, për të parandaluar përhapjen e zjarrit nëpërmjet zonave. Përpos mbrojtjes nga zjarri, Perdja e Sigurisë mundëson ndarje akustike për të parandaluar që audienca të dëgjojë zhurmat e padëshirueshme gjatë ndërrimit të aksesorëve në skenë.

- Pajisje për ngritjen e zinxhirëve në Paraskenë

Kjo pajisje përbëhet prej një çengeli me një zinxhir i cili përdoret për të vendosur dhe për të varur pajisje statike (që nuk lëvizin), pjesë e dekorit skenik. Këto pajisje janë të montuara në çengelë individualë të cilat mund të pozicionohen përgjatë trarëve mbi skenën ballore sipas performancave inividuale.

- Sistemi "fluturues" I fuqisë

Mundëson pajisje për ngritjen dhe uljen e skenës, perdeve maskuese, ndricuesit e skenës dhe pajisje të tjera brenda platformës në tavan. Cikrikët suportues janë të montuara në dhoma të dedikuara motorike në të majtë dhe të djathtë të skenës. Në total janë 12 të tilla cdo 400mm nga qendrat. Përvec këtyre, janë dhe 2 shufra të pozicionuara në skenën në të majtë dhe 2 në skenën në të djathtë, që lëvizin poshtë dhe lart.

- Zinxhirët mbi skenë

Ky set përbëhet nga një çengel me zinxhir i cili përdoret për të vendosur dhe për të varur pajisje statike (që nuk lëvizin) dhe pjesë të dekorit skenik. Keto pajisje janë të montuara në korniza individuale dhe mund të vendosen kudo mbi sipërfaqen përmbi skenë.

- Perdja

Perdja mundëson mbylljen e skenës para një performance. Perdja në vetvete është e përbërë nga dy copa, të cilat tërhiqen nga skena në të majtë dhe skena në të djathtë drejt qendrës, ku mbivendosen dhe mundësojnë maskim të skenës. Kjo perde është e fiksuar në një shufër "fluturuese" e cila ka shpejtësi të lartë dhe gjithashtu ngre dhe ul perden dekorative përpara audiencës.

- Sistemi I Kontrollit

Pajisjet e nenskenës dhe mbi skenes mund ti kontrollojë një sistem i përgjithshëm i kontrollit. Sistemi duhet të përmbajë një rrjet të kontrollit kryesor që siguron kontroll për çdo pajisje dhe një seri tavolinash kontrolli të madhësive të ndryshme që i japin operatorët (të) për të kontrolluar nga një pozicion qendror ose menjëherë ngjitur me pajisjet lëvizëse për efekte speciale dhe koordinim kompleks.

- Dyshemeja e fshehur e skenës

Dyshemeja e skenës përmban kolona të cilat hiqen dhe një strukturë me trarë çeliku e cila suporton një numër panelesh të lëvizshme me dimensione 2.4m x 1.2m, të cilat mundësojnë që skena të përdoret në performanca duke përfshirë pajisjet nënskenë ose dyert e fshehta të performuesëve. Dyshemeja e fshehur ka një sipërfaqe të përgjithshme prej 12m x 8m.

2.3.2 Zona e spektatorëve

Kjo zonë përbëhet nga: a. Platea
b. Galeria
c. Llozhat
d. Ballkonadat

Përmasat e sallës llogariten në bazë të numrit të spektatorëve, për një spektator ulur sipërfaqja duhet të jetë 0.5 m2.

Numri maksimal I karrikeve në një rrjesht nuk duhet të jetë më shumë se 16 dhe në cdo 10 rreshta një kalim 1.2 m. Korridoret anësore duhet të jenë 1.2 m dhe daljet më të mëdha se 3m. Volumi varet nga akustika: proza 4-5 m3 dhe opera 6-8m3.

Dimensionet standarte per spektatorët ulur

Karriget e audiencës në auditorin kryesor do të duhet të jenë të rehatshme, cilësore dhe estetike. Të gjitha ulëset në zonat kryesore dhe zonat e ballkonit të vendosen në rreshta lineare ose të lakuar duke ruajtur një shteg të qartë të daljes me anë të palosjes automatike të pjesës ulëse të karriges. Vendet të rregullohen me hyrje nga rrugicat dhe me një shumëllojshmëri të gjerësisë së sediljeve në mënyrë që të krijojnë një rregullim të stivosur midis rreshtave. Kjo do të krijojë pamjet më të mira për zonën e skenës. Modelet e ulëseve gjithashtu do duhet të modifikohen në varësi të vendndodhjes së tyre brenda auditorit. Këndet e pasme të sediljeve do të rregullohen sipas pamjes më të mirë drejt skenës.

Disa zona të auditorit do të kërkojnë fleksibilitet për të hequr vendet dhe për t'i ruajtur ato manualisht në zonën e poshtëskenës. Një model karrigesh do të kërkohet për të përmbushur këtë kërkesë në ashensorin e gropës së orkestrës dhe në zonat ku mund të vendosen karriget me rrota dhe mund të kërkojnë që vendet të përcaktohen në grupe për lehtësinë e transferimit. Vendet duhet të ndërtohen për të arritur të gjitha standardet e duhura të sigurisë dhe zjarrit. Tapiceria dhe veshja e sediljeve do të kërkohen për të arritur karakteristikat e sakta akustike të cilat do të përcaktohen gjatë zhvillimit të projektimit.

2.3.3 Zona e pushimit

Në këtë zonë përfshihen ambjente të barit, ambjentet e zyrave dhe magazinime. Këto sipërfaqe do llogariten nga projektuesi në varësi të funksioneve kryesore që ka objekti.

2.3.4 Zona e provave dhe e laboratorëve

- Dhomat e provave janë ambjente ku kryhen prova tavoline, prova skenike baleti dhe provat e orkestrës.
- Laboratorët janë dy llojesh skenografik dhe kostumografie
- Hapësirat e shërbimeve janë a. magazina skenografie b. magazine kostume, paruke, këpucë c. magazine materiale elektrike dhe d. ambjente zhveshjeje

2.3.5 Zona e administratës

Duhet që në teater të planifikohen zyra e drejtorit, sekretaria, llogaria, marrëdhëniet me jashtë, etj

2.3.6 Zona komunikuese, hyrjet, shkallët, korridoret, hollet

Duhet që ambjentet lidhëse të ndërtimit të projektohen në mënyrë të tillë që të mos shërbejnë vetëm si rrugëkalimi, por të kenë dhe qëllime të tjera në qoftë se është e nevojshme.

2.3.7 Sallat black box

Duhet që në projekt të planifikohen dhe sallat e njohura me emërtimin Black Box . Dizanji duhet të jetë i tillë që të akomodojë një sërë aktivitetesh dhe të jetë projektuar në mënyrë fleksibël. Këto salla duhet të konceptohen që të jenë të lehta në mirëmbajtje dhe të mirëorganizuara. Salla të ketë sistem audio dhe dhomë teknike për të komanduar ndricimin, audion, projektor etj. Të mendohet që salla të jetë e mirë projektuar nga ana akustike dhe të ketë një sistem të përgjithshëm kontrolli I cili mund të kontrollojë pajisjet mbi skenën. Sistemi duhet të përmbajë një rrjet kontrolli kryesor I cili mundëson kontrollin e secilës pajisje dhe një seri tavolinash kontrolli me përmasa të ndryshme, të cilat lejojnë operatorin të kontrollojë nga një pozicion qëndror ose direkt në anë të pajisjeve lëvizëse.

Njësitë e uljes në formë shkallë janë një mënyrë e shpejtë për të instaluar dhe për të cmontuar vende për tu ulur në rreshta brenda një dhome. Njësitë duhet të jenë në 5 rreshta platformash, 4 të lëvizshme dhe 1 statike. Cdo platformë përmban një rresht me karrige që palosen. Katër rreshtat lëvizës rrotullohen përmes kornizave me rrota, lart e poshtë në dhomë për tu shpërndarë dhe magazinuar.

2.3.8 Krijimi i një ambjenti për menaxhimin e situatave të emergjencës.
Teatriështe një vend ku hasen shumë njerëz, prandajështe e nevojshme krijimi I një ambjenti për situatat e emergjencës.

2.3.9 Hapësirat ndihmëse

Ambjentet higjeno-sanitare
Blloku sanitar që përfshin tualetet duhet të jetë në cdo kat.

Nyjet sanitare, për persona më aftësi të kufizuar
Për të gjitha kategoritë e ndërtimeve publike duhet të ketë minimumi një nyje ËC-je për këta persona. Për informacione të mëtejshme referojuni VKM 1503, datë 19.11.2008, "Për personat me aftësi të kufizuara".

2.3.10 Hapësira e shërbimeve

Ne hapësirat e shërbimeve të parashikohen ambientet e nevojshme dhe me siperfaqe sipas standarteve per krijimin e ambienteve për:

- dhomat e artistëve
- dhomat e solistëve
- dhoma provash
- magazine për vendosjen e materialeve të skenës
- ambjentet e mbrojtjes kundër zjarrit
- dhomat e trukimit dhe parukerisë
- locale për makineritë
- portineria
- magazinim (skenografi, costume, paruke, këpucë, material elektrike, instrumenta muzikore, rekuizit)

3. Kërkesa të veçanta

3.1 Projektimi për personat me nevoja të veçanta
Projektimi i ndërtesave duhet të sigurojë lëvizjen dhe qëndrimin e njerëzve me nevoja të veçanta, referuar legjislacionit përkates, për këtë kategori ndaj projektuesit duhen të bazohen në legjislacionin në fuqi por edhe në udhëzues ku janë paraqitur kushtet teknike më specifike.
Dimensionet e personave me nevoja të veçantë nëpër karrocat e invalidëve duhet të merret parasysh nga projektuesit gjatë caktimit të madhësisë së hapësirave të kalimit dhe qarkullimit.

3.2 Ndriçimi dhe Fonia
3.2.1 Ndriçimi për Skenën dhe Efektet

Duhet të specifikohet përzgjedhja e ndricuesve statik dhe automatik nga projektuesi. Shpërndarja do të bëhet sipas hapësirave për performancat; gjithsesi të gjithë ndricuesit duhet të kenë kapacitet përdorimi në cdo hapësirë performimi sic kërkohet nga nevojat e shfaqjes. Të gjithë ndricuesit duhet të jenë me burim LED, duke mundësuar energjinë me eficensën më të lartë të mundshme dhe funksionalitet të theksuar krahasuar me ndricimin tradicional. Një pjesë e ndricuesëve duhet të ketë funksione për ndryshimin e ngjyrës si opsione ekstra kreative. Përzgjedhja duhet të jetë e përshtatshme për krijime kreative dhe ndricim të performancave të ndryshme duke përfshirë opera, drama, teatër muzikor dhe kërcim.

3.2.2 Kabllot e ndricimit të skenës dhe aksesorët

Duhet të specifikohen kabllot dhe aksesorët në lidhje me ndricimin e skenës dhe efektet e dritave. Këto do të përfshijnë kabllo që mund të shpërndahen për lidhjen e ndricuesëve dhe

pajisjeve të tjera të infrastrukturës të instaluara në një shumëllojshmëri konfigurimesh.

3.2.3 Pajisjet e Zërit dhe Komunikimit

Paketa e pajisjeve të zërit dhe komunikimit duhet të parashikoje:
- Sistem loudspeaker për përforcimin e tingullit
- Rrjet Digital audio për shpërndarjen në kohë reale të audios
- Linjë Digital intercom dhe wireless intercom për komunikimet me skenën
-Tavolina e menaxherit të skenës dhe dritave sinjalizuese për koordinimin teknik të performancave dhe provave.
- Sistem njoftimi për lajmërimet ndaj performuesve dhe stafit teknik.
- Dëgjim me lidhje wireless
- Pajisje për Video projektim për projektim digital dhe prezantim AV
- Mikrofona me wireless dhe kabllo.

Sistemet duhet të jenë fleksibël dhe të konfigurueshme duke lejuar performance teatrale në shkalle të vogël e të mesme, koncerte muzikore dhe evente të tjera.

3.3 Komoditeti termik, vizual, akustik

3.3.1 Komoditeti termik

Ventilimi i objektit te projektohet i tille qe te garantoje cilesine e ajrit permes ventilimit natyror. Ne ambjentet qe ventilimi natyrior nuk eshte i mundur, ateher te mendohet zgjidhja nepermjet sistemeve artificiale te ventilimit.
Të përdoren materiale, që përfshijnë materialet e fasadave me reflektim të mundshëm të diellit, materialet izoluese për rritjen e veprimit termik të mureve, materiale që duhet të jenë joalergjike apo të dëmshme për shëndetin e frekuentuesve dhe aktorëve.

Standardi i izolimit
Vëmendje të veçantë duhet tu kushtohet zonave të ashtuquajtura ura termike si p.sh. tavanet e mureve të jashtëm, pasi këtu temperatura e sipërfaqes mund të jetë më e ulët se sa ajo e elementeve konstruktive në zonat e rregullta.

Urat termike
Kërkesa e vlerave të U(w/m²K)(koeficientii transmetimit termik)
Sipas legjislacionit ne fuqi (Ligji Nr. 8937 dt. 12.09.2002 „Për ruajtjen e nxehtësise në ndërtesa" dhe akteve nenligjore përkatese VKM Nr. 38 dt. 16.01.2003 „Për miratimin e normave, rregullave dhe kushteve te projektimit dhe të ndërtimit, të prodhimit dhe ruajtjes së nxehtësisë në ndërtesa") për zonën klimatike A të cilës i përket Tirana (me pak se 1500 Gradë Ditë Ngrohje në vit). Koeficienti i humbjeve volumore Gv per ndertesa eshte midis 0.54 – 1.03 Ë/m³°C. Vlera me e vogël është për ndërtesa me raport S/V (sipërfaqe të jashtme/volum i ngrohur) me të vogël se 0.3 dhe vlera me e larte per ndertesa me raport S/V me te madh se 0.9. Për ndërtesa me S/V ndërmjet këtyre vlerave, koeficienti Gv llogaritet proporcionalisht. Në mënyrë që koeficienti I humbjeve volumore të plotësojë kërkesat e ligjit duke respektuar njëkohësisht dhe kriterin ekonomik kosto-përfitim, është llogaritur që ndërtesat në Tiranë duhet të kenë një shtrese

termoizolimi te jashtëm (tip kapote) polisterol EPS me trashesi 5 cm (U = 0.35 Ë/m□K) ose me fiber minerale me te njëjtat parametra të transmetimit të nxehtësisë dhe me dritare me dopjo-xham (6 x 12 x 6 mm) me profil plastic ose alumin me termoizolim. Shtresa termoizoluese duhet të jetë e instaluar nga jashtë dhe të respektohen me rigorozitet kërkesat e prodhuesve për mënyrën e fiksimit (përvec materialit ngjitës edhe me sistem montimi me vida-upa plastik) si dhe shtresa e barrieres së avujve te ujit. Cdo mënyrë tjeter instalimi rrezikon të shkatojë kondensim në muret e brendshme, krijim myku, dhe dëmtim te shtreses se termoizolimit.

Dritaret dhe Dyert
Duhet t’u kushtohet rëndësi elementeve si lartësia dhe kornizat e dritareve, lloji i xhamit, qartësia e pamjes, kontrolli i dritës, impakti i vlerësimit të riskut, si dhe faktorët e sigurisë. Projektuesi duhet të përpiqet që të planifikojë të paktën një dritare të jashtme për ambjent. Në rast se kjo nuk mund të bëhet por hapësira e brendshme projektimi duhet të parashikojë depërtimin më të mirë të dritës dhe pamjes nëpërmjet vetratave, dritareve anësore, dritareve dhe dyerve me xham (të sigurta).
Sipërfaqet që nuk kanë nevojë për dritare janë tualetet, dhoma e konferencave, holli dhe depot.
Nuk lejohet vendosja e skarave metalike në dritare.
Dritaret e jashtme dhe dyert e jashtme me xham duhet te jene me kase me material PVC me ndarje termike ose kase alumini gjithashtu me ndarje termike. Specifikimet teknike te dritareve duhet te jene te detajuara dhe te marrin parasysh te pakten pikat me poshte:
Koeficientin U - 1.2 (ë/m²K)
Ndarjen Termike –
Qendrueshmerine ndaj faktoreve atmosferike –
Aftesine ze-izoluese – (klasi 4)
Veshja me xham duhet të provojë nje vlerë të lartë të izolimit ndaj rrezeve të diellit. Kjo vlerë specifikon sa i lartë është rrezatimi diellor, i cili depërton nëpërmjet xhamit dhe ndihmon kështu në ngrohjen e ndërtesës.Tek xhamat e sotëm të dritareve të termoziluara kjo vlerë këshillohet rreth g = 60%.
Për të shmangur urat termike, duhet që dritarja të montohet nën nivelin e termoizolimit ose të paktën të montohet në këndin e jashtëm të murit. Izolimi kështu vendoset mbi kornizën e dritares. Duhet të kihet patjetër kujdes që gjatë momentit të montimit të realizohet një bashkim hermetikisht i vazhdueshëm i dritares. Montimi me ndihmën e shkumës nuk është i mjaftueshëm, meqenëse ajo në fazën e tharjes mblidhet dhe kështu nuk garanton më një izolim hermetik.

3.3.3 Komoditeti Akustik

Pjesët e poshtme të mureve duhet të jenë reflektuese në mënyrë akustike, d.m.th të forta siç janë druri, tulla, plasteri ose betoni.

Është e këshillueshme që gjatë projektimit të merren parasysh këto rekomandime:

- Të gjitha tubacionet (ajrit të kondicionuar, furnizimit hidrik) që përshkojnë muret që tejçojnë zhurma duhet të vishen me material për mbrojtje akustike;
- Në mjediset ku mendohet se mund të krijohen nivele akustike të larta të vendosen elemente të mobilimit të tilla që të ndihmojnë në uljen e niveleve akustike si p.sh. në korridorre të vendosen linoleum, tapet etj;

- aty ku mundet suvatimi të jetë me materiale që zbusin nivelin akustik;
- për të ulur nivelet akustike, gjatë projektimit të mendohet të përdoren materiale për të zbutur zhurmat;
- xhamat e dyerve dhe dritareve duhet të jenë qelq i laminuar akustikisht me nj aftësi izolimi akustik 35dB, me hapësirë ajri nga 50mm deri në 100 mm;
- dyert që hapen nga zonat e zhurmshme duhet të sigurojnë një izolim të lartë akustik
- këshillohet të përdoren materiale tekstile për të ulur nivelin akustik;
- për të izoluar sa më mirë zonën e dhomave me pjesën e jashtme apo me pjesën e administratës mund të përdoren edhe dopio dyer ose sistemi tambur. E njëjta gjë këshillohet edhe për dritaret në zgjidhjen e dritareve dopio. Kjo zgjidhje ndihmon edhe për të arritur një izolim më të mirë termik duke pasur parasysh që dyert dhe dritaret janë dhe zonat më delikate në kuptimin akustik edhe termik;
- kutitë e prizave elektrike nuk duhet të instalohen me kurriz.

4. Impiantet teknike

Projektet e impiantistikes do ti referohen kushteve teknike të projektimit dhe te standardeve te Republikës se Shqipërisë (K.T.P - STASH) dhe për elementet te veçante që nuk janë parashikuar në këto norma, do ti referohet euronormave (EN) dhe eurostandart (EN,HD) si dhe rekomandimeve të CEI, CENELC, DIN, VDI/VDE, ose normave lokale dhe standardeve te Komunitetit Evropian.

Projektet e impiantistikes duhet te permbajne:

Projekti i plotë i ngrohjes dhe ventilimit shoqeruar me detajet perkatese, listen e materialeve dhe specifikimet teknike të materialeve.
Projekti i plotë i rrjetit elektrik (përfshirë sistemin telefonik dhe kompjuterik) i shoqëruar me detajet përkatëse dhe tabelen e materialeve dhe specifikimet teknike te materialeve
Projekti i plotë i ujësjellësit i shoqëruar me detajet përkatëse dhe tabelen e materialeve dhe specifikimet teknike te materialeve
Projekti i plotë i kanalizimeve i shoqëruar me detajet përkatëse dhe tabelen e materialeve dhe specifikimet teknike te materialeve
Projekti i plotë i mbrojtjes kundra zjarrit i shoqëruar me detajet përkatëse dhe tabelen e materialeve dhe specifikimet teknike te materialeve.
Specifikimet përfundimtare të materialeve dhe pajisjeve.
Metodologjia e zbatimit të punimeve duke specifikuar mënyrën e ruajtjes së ambientit të ndërtimit nga ndotja. (projekt mjedisor)

4.1 Projekti i plotë i ngrohjes dhe ventilimit

Normat projektuese dhe vlerat e rekomanduara të temperaturave të ambienteve
Kushtet termike brenda ndërtesave duhet të jenë të përshtatshme per aktivitetin qe kryhet ne to. Ȅshtë e nevojshme që projektuesi të marrë në konsideratë funksionin e mjediseve dhe aktivitetin që kryhet.

Impiantet mekanike janë mjaft të rëndësishme për funksionimin e një godine dhe zhvillimin

normal të aktivitetit për të cilën destinohet të shfrytëzohet nga përdoruesit.
Pavarësisht funksionit dhe përdorimit të godinave, impiantet mekanike duhet të plotësojnë kriteret bazë të domosdoshme përkundrejt projektimit, zbatimit të punimeve në objekt dhe shfrytëzimin nga përdoruesit të cilat janë:

- Përshtatshmëri dhe komfort në përdorim,
- Besueshmëri në funksionin e tyre,
- Kontroll të plotë teknik,
- Të garantojë kushtet higjenike dhe siguri teknike,
- Të mundësojë përdorim parcial të adresuar,
- Të garantojë kursim të energjisë së përdorur,
- Të respektojë kushtet ambientale,
- Të garantojë kosto të ulëta mirëmbajtje,
- Të ndërtohet me komponentë standard.

Projektet, punimet e zbatimit dhe shfrytëzimit nga përdoruesit mbështeten në kuadrin ligjor dhe V.K.M-të e Republikës së Shqipërisë dhe në rastet kur ky kuadër nuk parashikon terma ose argumenta të veçantë, ato mbështeten në standarted, norma dhe udhëzime kryesisht italiane (UNI,UNIEN) dhe europiane (ISO, EN).

4.2 Ventilimi

Duke qënë se në ambientet e teatrit kemi të bëjmë me zona me densistet të lartë të popullimit, sistemi i ventilimi për këto ambiente duhet të projektohet në mënyrë të tillë që të arrijë të plotësojë qellimet kryesore të aplikimit të tij si:

a. Duhet të arrijë të plotësojë kërkesën për ventilim dhe furnizim me ajër të freskët për personat që do përdorin këto ambiente
b. Duhet të siguroj largimin e ndotësve dhe aromat e këqija nga ambientet duke bërë të mundur përmirësimin e cilësisë së ajrit.
c. Mundësisht të rregullojë përqëndrimin e lagështisë të ajrit në ambiente.
d. Përmirësimin e komfortit termik duke ruajtur regjimin termik të impianteve të ngrohjes/ftohjes.

.
Tubacionet e ajrit dhe grilat duhet te jene te dimensionuara ne menyre te tille qe te garantohet shperndarje e mire e ajrit dhe niveli i zhurmave te jete brenda normave te lejuara per secilin ambjent. Tubacionet e ajrit duhet te jene te termoizoluara.
Sistemi i ventilimit duhet te projektohet ne mënyre të tillë që në rast zjarri të fiken automatikisht dhe nëse do të projektohen si njësi qendrore (qe i sherbejne me shume sesa nje ambjenti), te parashikohen damferat e zjarrit

Ventilimi i nyjeve sanitare
Në ventilimin e nyjeve sanitare duhet të respektohen:

- Shpejtësia e ajrit nuk duhet ti kalojë 6m/s.
- Tubacionet fleksible nuk duhet të kalojnë 3000 mm gjatësi.
- Pikat e thithjes së ajrit duhet të pozicionohen mbi cdo ambient të mbullur.

4.3 Projekti i rrjetit elektrik
Sherbimet elektrike perfshijne furnizimin me energji elektrike, shpërndarjen e energjisë, energjine ne raste emergjente dhe ate ne pritje, mbrojtjen nga sharkimet atmosferike dhe tokezimin mbrojtes, ndricimi, sistemin e fuqise sistemet Securiti dhe teknologjine e informacionit dhe komunikimit ICCT.
Sistemet e emergjences perfshijne sistemin e mbrojtjes nga zjarri dhe sistemin e ndricimit emergjent.
Llogaritjet të bëhen duke u bazuar ne Ë/m2 ne baze te perdoimit per cdo ambjent.
Verifikimi i Punes: Kontraktori duhet te njihet me te gjitha detajet e punes,duhet te verifikoje te gjitha permasat dhe te dhenat dhe duhet te njoftoje Supervizorin.

Konfigurimi i sistemit.
Konfigurimi i ndriçimit duhet te jete sipas normes :
EN 12464: nen shqyrtimin e kritereve te cilesise se pergjithshme per ndriçim.
Llogaritja e ndriçimit eshte bere permes programeve te simulimit DIALUX
Per ridimensionimin e sistemit te ndriçimit supozimet duhet ti referohen EN 12464
Skenat e Teatrit do te trajtohen me ndricim specifik Skenik
Furnizimi i ndriçimit do te behet nepermjet qarqeve kryesore dhe gjeneratorit. Ndarja e ngarkeses do te behet nepermjet qarqeve te veçanta.
Kontrolli i ndriçimit duhet te komandohet ne menyre qe ne rastin e nje alarm zjarri 75% e te gjithe ndricimit te jete i ndezur. Zonat si dhoma e paneleve etj, duhet te jene te pajisura me ndriçim dhe komandim lokal. Gjithe qarku i ndriçimit do te jete veçmas ne nje panel. Çdo grup mund te kontrollohet manualisht nga celesa ose pulsant .Te gjithe ndricuesit do te jene te tipit LED.

4.4 Rrjeti kompjuterik dhe rack-et

Raku kryesor i IT do te jete ne ambientet e dhomes IT. Racku do te perfshije te gjithe kabllot e telekomunikacionit dhe paisjet.

4.5 Sistemi i kamerave CCTV
Duke marrë në kosideratë rëndësinë e objektit në parametrat e projektimit të sistemit CCTV të merren në konsideratë:
- Cilesi e larte e sistemit te monitorimit CCTV ne te gjithe godinen per arsye sigurie.
- Monitorim i korridoreve dalese.
- Monitorim i te gjithe dyerve te jashtme.
- Pozicioni i kameres dhe specifikimi i lentes per nje minimum ½ e monitorimit te lartesise mesatare te personit ne distance maksimale.
- Kamera IP te brendshme me ngjyra.
- Stacioni qendror i monitorimit
- Konfigurimi i sistemit
- Sistemi CCTV të perbehet nga kamera fikse te insaluara ne tek hyrjet/daljet e objektit si dhe ne pikat ku monitorohen ambjentet e kalimit dhe ambjentet kryesore te Teatrit.

4.6 Projekti i furnizimit me ujë
Furnizimi me uji të ftohte/ngrohte sanitar është i domosdoshëm për zhvillimin normal të

aktivitetit .
Furnizimi me uji i mjediseve të godines mund të kryhet nga rrjeti urban ose prej puseve në rastet kur rrjeti urban nuk garanton nevojat për uji të këtyre ambienteve.
Gjithashtu krahës nevojës për kapacitet rezervë uji që do të shërbej për sistemin e mbrojtjes ndaj zjarrit duhet të sigurohet dhe sasia e nevojshme rezervë për nevoja konsumi në bazë të numurit të perdoruesve.

Furnizimi i ujit të ftohtë sanitar bëhet nëpërmjet rrjetit të jashtëm nga puseta e kontrollit. Pika e lidhjes duhet rakorduar me ndermarrjen e ujesjellesit. Sistemi i furnizimit me ujë nga rrjeti i jashtëm duhet të garantoje ujë të mjaftueshëm për përdorim sanitar. Nëpermjet prurjes dhe presionit që ka rrjeti i jashtëm bëhet furnizimi i rezervave të përgjithëshme të ujit. Një grup furnizimi me ujë duhet të përbëhet nga: matësi i ujit, reduktori i presionit, saraçineskat, valvula e moskthimit dhe filtëri "Y". Grupi i pompimit duhet vendosur në ambientin teknik.
Rezervuarët e ujit duhet të llogariten dhe dimesionohen në mënyrë që të sigurojnë sasi uji për një autonomi të kërkuar (ndoshta 1 dite). Specifikimet (sasia, kapaciteti etj) duhet të përcaktohen nga projektuesi në bazë të diagramës së shfrytezimit ditor nga konsumatoret. Pervec rezervuareve te ujit te ftohte sanitar te vendosur ne ambjentin teknik, projekti duhet te permbaje dhe nje depozite uji me renie te lire si dhe lidhjen e tij me ËC-te dhe pisuaret per raste kur mund te kete mungese te energjise elektrike. Vellimi i depozites duhet llogaritur nga projektuesi dhe te kete autonomi te pakten 1 dite.

Sistemi i ujit sanitar do të shërbejë për të siguruar ujin e ftohtë dhe të ngrohtë nga stacioni i pompimit tek kolektorët dhe mbas kësaj të sigurojë shpërndarjen e ujit në pajisjet e ambienteve sanitare.
Shperndarja e ujit të ngrohtë sanitar realizohet nëpërmjet:
- Linjat e shpërndarjes se ujit të ngrohtë;
- Riqarkullimi i ujit të ngrohtë (nese do zgjidhet varianti me boiler qendror te ujit te ngrohte)
- Kolektoret e furnizimit me ujë (nese do zgjidhet varianti me kolektor nga projektuesi)

4.7 Projekti i shkarkimit të urjave

Sistemi i shkarkimit të ujrave në tërësinë e tij përmban rrjetin e mbledhjes se ujrave atmosferike,ujrave te zeza, ujrave gri dhe ujrave me permbajtje yndyrore.
Dimensonimi i rrjeteve të sistemit shkarkimit, vlerat normative të shkarkimit
Dimensionimi i rrjetit të shkarkimit të ujrave te bëhet duke u bazuar në llogaritjen e prurjeve për njësi të shkarkimit të paisjeve të ndryshme, në shpejtësinë e rrjedhjes së lëngjeve në tuba dhe pjerrësia e tubacionit. Rrjedhja e ujit në sistemin e shkarkimit duhet të mos krijojë presione që krijojnë grushte hidraulike në tubacione.Tubat duhet të kenë një diametër të mjaftueshëm që të lejojnë qarkullimin e lirë të ventilimit të ajrit e cila stabilizon presionin e rrjetit.

4.8 Projekti i mbrojtjes kundra zjarrit dhe shpetimit (MKZSH)

Sistemi i mbrojtjes kunder zjarrit te realziohet ne baze të: Normave, rregulloreve dhe kritereve projektuese të vendeve të Komunitetit Europian si dhe në përputhje me rregulloret MKZSH ne Shqiperi.

Norma UNI 9490 per "Pajisjet e shuarjes se zjarrit dhe rezerva ujore per impiantet automatike te mbrojtjes nga zjarri". Kjo norme përcakton qartë komponentet që duhet të ketë Impianti i Mbrojtjes Kundra Zjarrit, percakton rezerven ujore, te jete e akumuluar ne rezervuar fiks te pashtershem, te jete e paster pa përmbajtje algash, materiale korrozive apo materiale te tjera suspance, te jete e paprekshem ne cfaredolloj rasti.
Ligji Nr. 8766, datë 5 .4.2001 (Ndryshuar me ligjin nr. 10 137, datë 11.5.2009 nr. 11/2013, datë 14.2.2013) (I përditësuar) "PËR MBROJTJEN NGA ZJARRI DHE PËR SHPËTIMIN"
Ky ligj percakton qarte strukturen dhe veprimtarine e PMNZSH□se ne rast zjarri si dhe menyren e mbrojtes se objekteve nga ana e ketij personeli; gadishmerine dhe masat parandaluese e mbrojtese qe duhet te nderrmari personeli ne rast zjarri.
VENDIM Nr.699, datë 22.10.2004 PËR "MIRATIMIN E RREGULLAVE TEKNIKE PËR MBROJTJEN NGA ZJARRI DHE PËR SHPËTIMIN NË KONSTRUKSIONET DHE NDËRTIMET, QË SHËRBEJNË PËR VEPRIMTARI AKOMODUESE TURISTIKE"

4.9 Impianti i ajrit të kondicionuar

Impjanti i Ajrit te Kondicionuar duhet të jetë nje sistem qendror i afte te garantoje ne menyre te pavarur kushtet e komfortit termik ne cdo ambjent te godines si zonat e publikut(salla e shfaqeve, skena, hollet, etj.), ambjentet e pergatitjes se aktoreve, ambjentet administrative si dhe ambjentet ndihmese dhe te shërbimit.

Normativat dhe Standartet
Projekti HVAC do të mare ne konsiderate standartet e reja Europiane ne lidhje me kursimin energjitik, nivelet e zhurmes dhe emetimeve atmosferike si edhe standartet nderkombetare (ASHRAE). Per arritjen e eficences energjitike sistemi HVAC do te garantoje nje pavarësi dhe përshtatshmëri të lartë të kushteve te komfortit termik te brendshem ne varesi te ndryshimit te kushteve te jashtme (klimaterike) dhe te brendshme, (niveli i njerezve ne salla) me kursimin maksimal energjitik.
Qellimi kryesor është të sigurohen kushte e komfortit ne cdo ambjent, thjeshte dhe ne menyre eficente ndermjet te cilave:
- kontrolli i saktë i temperaturës dhe lagështisë, cilesise se ajrit dhe qetesise ne salle;
- rikuperimin e energjisë se ajrit te e flakur per ventilim;
- përshtatja e sistemit me kushte variabel ne foyer dhe sallen e shfaqeve.

Sistemi HVAC duhet të jetë i pajisur me një sistem qendror të menaxhimit dhe te kontrollit per te gjithe godinen.

5. KONSTRUKSIONI

STANDARDET REFERUESE

Eurocodet
Kushtet shqiptare të projektimit
Kushtet teknike të projektimit për ndërtimet antisizmikeKTP-N.2-89

Në eurocode janë të percaktuara me detaje llojet e ngarkesave (të përhershme, të përkohëshme, borë dhe erë si dhe kombinimet e tyre ) të cilat duhen marë në konsideratë gjatë analizimit të strukturës.

Përpara hartimit të projektit duhet të merret parasysh studimi gjeologjik dhe sizmik për terrenin në të cilin ndërtohet objekti.

6. FAZAT E PROJEKTIMIT
Realizimi i projektit do të mbështet në fazat e VKM Nr. 354, datë 11.05.2016, Neni 42, Neni 43, Faza I-VI të nenit respektiv sipas tipologjisë.

FAZA I Analiza e detyrës së projektimit
Analiza e detyrës së projektimit/termave të referencës dhe përcaktimi i bazës së projektit (format A4); Vëzhgimi dhe mbledhja e dokumenteve fartografike për zonën në të cilën duhet ndërhyrë - ( formati A3/A2).
Materiali grafik i përgatitur nga konsulenti duhet të përfshijë:
-Pozicionimin në harte;
-Përshkrimin e situatës aktuale;
-Verifikimin e projekteve/studimeve të miratuara për zonën objekt studimi etj.
Fletët grafike do të përgatiten bazuar në vrojtimin; ato duhet të jenë lehtësisht të lexueshme dhe të kuptueshme.
Materialet dorëzohen në 1 kopje format hard copy ( të printuar) dhe 1 cd në format soft copy ( cad,exel,word).

FAZA II Projekt ide paraprake (Përgatitja e projektit dhe planifikimit).
Përpunimi pjesëve të rëndësishme të një zgjidhjeje të detyrës së planifikimit, e cila do paraqitet në jo më pak se 2 variant-propozime, ku për secilin variant do dorëzohet:
1. Analiza e e bazës materiale dhe e parimeve;
2. Vlerësimi i ndërtimeve ekzistuese (evidentimi i objekteve që prishen/ruhen)
3. Vizatimet teknike :planimetri të përgjithshme, planvendosje, fasadat në 2D
4. Relacion teknik (mbi ndërhyrjet e parashikuara);
5. Preventiv paraprak.

Varianti me treguesit më social - ekonomik dhe teknik, që do të përzgjidhet nga Këshilli Teknik, do të vazhdojë procedurën e hartimit të projekt-idesë përfundimtare.
(Të paraqiten variantet e propozuar me preventivat paraprake e specifikimet përkatëse duke përfshirë dhe kostot e shpronësimeve, nëse ka, për secilin variant).
Materialet dorëzohen në 1 kopje format hard copy ( të printuar) dhe 1 cd në format soft copy ( cad,exel,word).

FAZA III Projekt ide përfundimtare (planifikimi i sistemit dhe i integrimit)

Përpunimi i zgjidhjes përfundimtare të detyrës së planifikimit.

Në këtë fazë konsulenti duhet të përgatisë projekt idenë përfundimtare të ndërhyrjeve, pas miratimit në Këshill Teknik të variantit socio-ekonomik dhe teknik më të përshtatshëm të miratuar në fazën e projekt idesë-paraprake, e cila duhet të përmbajë:

a. Raport teknik;
b. Preventivin e punimeve sipas formatit të miratuar nga Bashkia Tiranë, referuar VKM nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”;
c. Analizat teknike të çmimeve, për zërat, që nuk ndodhen në VKM nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”;
d. Vizatimet teknike për të gjitha punimet e parashikuara me detajet përkatëse;
e. Specifikimet teknike për zërat e punimeve, që do të kryhen;
f. Grafikun e punimeve të detajuar sipas zërave të punës;
g. Rilevimi;
h. Studimi gjeologjik.

Materialet dorëzohen në 1 kopje format hard copy ( të printuar) dhe 1 cd në format soft copy ( cad,exel,word).
Pranë Drejtorive përkatëse të Bashkisë dhe institucioneve në varësi, kryhet aplikimi, nga ana e operatorit ekonomik të kontraktuar për hartimin e studim-projektimit, për vendosjen në dispozicion të informacionit në lidhje me azhornimet inxhinierike, statusin juridik të pronës etj.
FAZA IV: Projekti për miratimin e lejes së ndërtimit: Përpunimi dhe dorëzimi i dokumentave për procedurat e nevojshme juridike e ligjore.
Projektuesi gjithashtu duhet të parashikojë dhe projektin për miratimin e lejes së ndërtimit, si i cili duhet të mbështetet në ligjin Nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”. Eshtë përgjegjësi e projektuesit aplikimi për leje ndërtimi nëpërmjet sistemit të aplikimit të lejeve on-line.
Për këtë për çdo dokumentacion të nevojshëm për hartimin e projektit si dhe për aplikimin për leje ndërtimi përmes portalit të Regjistrit të Integruar të Territorit, të bashkëpunohet me Drejtoritë përkatëse të Bashkisë Tiranë.
Materialet dorëzohen në 2 kopje cd, projekti dhe dokumentacioni shoqërues me vulë elektronike.

FAZA V: Projekti zbatimit: Përpunimi dhe paraqitja e planit të zgjidhjes së gatshme për zbatim.

Dosja e plotë e projektit të zbatimit për objektin: “Ndërtimi i Teatrit Kombëtar” duhet të përmbajë:

1. Raportet teknike (konstruktiv, arkitektonik, topografik, gjeologjik, hidroteknik, elektrik, kondicionimi, eficenca energjitike, kush/kuz,)
Raporti përfundimtar teknik përfshin të gjitha informacionet në lidhje me projektin, duke shpjeguar arsyet në të cilat u bazua skema e detajuar e projektit. Ai përshkruan analizën e bërë nga projektuesi për situatën dhe projektin e propozuar. Raporti të sigurojë të dhëna të sakta, bazuar në testet / vlerësimet ekzistuese, llogaritjet e bëra, llogaritja e eficences energjitike, ndriçimit, etj., masat inxhinierike që parashikohen të merren, etj.
2. Projektin arkitektonik: Relacion arkitektonik i objektit, Fasadat, Planimetritë ekzistuese dhe të reja të objektit, Prerjet e godinës, Plan mobilimin e ambienteve, Plani i mbulesës, etj;
3. Projektin e zbatimit/konstruksionin të objektit: Plani i strukturave dhe detajet, Plani i

themeleve, etj.

4. Projekt Zbatimin e instalimeve hidrosanitare, të kanalizimeve
5. Projekt Zbatimin e instalimeve elektrike, të shoqëruara me licencën e noteruar të projektuesit
6. Projekt Zbatimin e instalimit te sistemit të ngrohjes, të mbrojtjes kundër zjarrit të strukturës të miratuar nga Drejtoria e Zjarrit dhe Shpëtimit
7. Projektin e sistemimit;
8. Rilevimin topografik
9. Studimin gjeologo-inxhinierik
10. Studimi sizmologjik
11. Projektin e zbatimit të rrjetit të kanalizimeve të largimit të ujërave të shiut;
12. Rekomandime për materialet e ndërtimit që do të përdoren
13. Relacionin gjeologjik
14. Projektin e zbatimit të rrjetit të kanalizimeve të ujërave të zeza;
15. Projektin e zbatimit të rrjetit të ujësjellësit, përfshirë dhe detajet e pusetave të pajisjeve dhe rakorderive të nyjeve, etj;
16. Specifikimet teknike për zërat e punimeve që do të kryhen;

Kontraktuesi duhet të përgatisë specifikimet teknike për secilën material që do të përdoret. Për secilën punë të përfshirë në preventiv, duhet të bëhet analiza sipas kësaj skeme:

- Përshkrimi i detajuar i procesit të punës;
- Metoda e vendosjes;
- Cilësia e kërkuar;
- Format e miratuara;
- Ngjyra e rekomanduar
- Skica, vizatime ose foto

17. Preventivin e punimeve mbështetur në manualet teknike të çmimeve në fuqi;
18. Analizat teknike të çmimeve të zërave të punime që nuk janë në manual;
19. Grafikun e punimeve të detajuar sipas zërave të punës;
20. Plan organizimin e punimeve dhe ngritjen e kantierit në funksion të mjeteve, që do të jenë pjesë e realizimit të objektit, mbështetur dhe në grafikun e punimeve;
21. Raportin e vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM);
22. Liçensë të firmës projektuese, liçensë të ekspertit mjedisor dhe ekstrakt i regjistrit tregtar.
23. Deklaratat e përgjegjësisë profesionale të stafit pjesmarrës në realizimin e studim-projektimit

Materialet dorëzohen në 5 kopje format hard copy ( të printuar) dhe 5 cd ( 4 cd në format soft copy cad,exel,word etj dhe 1 cd në format pdf).

FAZA VI: Hartimi i preventivit përfundimtar

Për hartimin e preventivit projektuesi duhet të mbështetet në VKM NR. 629, datët. 15.07.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre".

Për secilin zë punimi, i cili nuk është i përfshirë në këtë manual, projektuesi duhet të dorëzojë analizat/ofertat përkatëse të çmimeve.

Në hartimin e preventivit, veç të tjerave do të mbahen parasysh sa më lart, lidhur me organizmin

e zbatimit me faza, çmimet e referencës sipas akteve ligjore në fuqi, dhe llogaritja e preventivit do të bëhet sipas normave dhe akteve ligjore në fuqi për të siguruar kursimin dhe efiçencën e përdorimit të fondeve.
Preventivi do të hartohe sipas formatit/modelit standart të rekomanduar nga Bashkia Tiranë.

7. Rekomandime per projektuesin

Standarde në Projektim

Projekti do të hartohet në përputhje me të gjitha normat dhe standardet për projektim që parashikon legjislacioni në fuqi. Projektimi duhet të sigurojë respektimin e standardeve, madje edhe atyre gjatë zbatimit. Është përgjegjësi e Projektuesit saktësia dhe respektimi i të gjitha standardeve dhe normave përkatëse. Projektuesi mund të rekomandojë edhe prezantimin e standardeve të reja, për përafrimin me normat e BE-se, si dhe të praktikave më të mira ndërkombëtare në projektim dhe zbatim. Rekomandimet duhet të përmbajnë elemente të fizibilitetit dhe realizueshmërisë me praktikën shqiptare dhe limitimet për financimin e veprës. Në hartimin e projektit të mbahen parasysh të gjitha normat e miratuar për personat me aftësi të kufizuar, të verbrit, etj. Në projekt të parashikohet infrastruktura e nevojshme për këtë kategori.Standarde në paraqitjen e dokumentacionit teknik:
Në hartimin dhe paraqitjen e dokumentacionit të projektit, projektuesi të përdorë programet e kërkuara kompjuterike, si dhe të nxitet përdorimi i programeve të reja, më të avancuara të fushës.
8. Paraqitja e vizatimeve.

Vizatimet duhet të jenë të lexueshme dhe të përmbajnë si minimum fletët si më poshtë:

1. Topografinë e gjendjes ekzistuese në të cilën të jenë të azhornuara të gjitha ndërtimet në gjendjen e sotme (me leje dhe pa leje)
2. Zhvillimi i koncept idesë për objektin
3. Planvendosjen e objektit në Shk 1:100
4. Planimetria e përgjithshme e objektit në Shk. 1:200; 1:500
5. Fasadat në 2D dhe 3D Shk.1:100
6. Prerjet e godinës (në të dy drejtimet) Shk.1:100
7. Planin e tarrace ose catise Shk.1:100
8. Planimetria e themeleve Shk.1:100
9. Prerje të themeleve dhe detajet Shk.1:20; 1:10
10. Plani i strukturave detaje Shk.1:100; Shk.1:50
11. Planimetritë e mobilimit Shk.1:100
12. Planimetria e rrjetit të kanalizimeve në shkallën Shk. 1: 100
13. Puseta dhe detaje të tjera të rrjetit të kanalizimeve Shk.1:10, 1:20
14. Puseta dhe detaje të tjera të rrjetit të ujësjellësit Shk.1:20, 1:10
15. Skemat aksonometrike të furnizimit me ujë, detaje të pajisjeve hidrosanitare Shk.1:100
16. Planimetria dhe detaje të sistemit te mbrojtjes kundër zjarrit Shk.1:100
17. Planimetria, aksonometria dhe detaje të sistemit të ngrohjes Shk.1:100
18. Planimetria e dhomës së kaldajës, konstruksioni, detaje Shk.1:100;1:50
19. Planimetri dhe detaje për ndriçimin, fiksimin e ndriçuesve në tavan, instalimin e kuadrit kryesor etj. Shk.1:100;1:50

20. Planimetria e skemës së shpërndarjes së fuqisë në të gjithë objekti, Shk. 1:100
21. Planimetritë për telefoninë, rrjetin e internetit Shk.1:100; 1:50
22. Planimetria e ndriçimit të jashtëm dhe detaje të tij Shk.1:100; 1:50
23. Planimetria disiplinimit dhe shkarkimit të ujërave sipërfaqësore dhe detajet përkatëse shk.1: 100; 1:50.
24. Plan qarkullimi i personave me aftesi te kufizuar
25. Planvendosja e objektit në shkallën 1 : 1000 format A3;

Të gjitha fletët e vizatimeve duhet të jenë të detajuara me elementët përkatës, si dhe legjendat përkatëse.

Relacionet shoqëruese

1. Vleresimi i Ndikimit ne Mjedis
2. Raport elektrik
3. Raport teknik
4. Raport hidro, kush, kuz
5. Raport konstruktiv+ llogaritjet e struktures
6. Raport i sistemeve mekanike, ngrohje – ftohje, mnz. Etj...
7. Raport arkitektonik
8. Raport teknik
9. Preventiv
10. Rilevimi
11. Studimi sizmiologjik
12. Studimi gjeollogjik
13. Grafiku i punimeve
14. Licensat e stafit projektues
15. Deklaratat e stafit pjesmarres ne hartimin e projektit

9.Raportimi dhe dorëzimi final

Dorëzimi final, fizik, i projektit të zbatimit, do të konsiderohet ai, i cili do të ketë kaluar njëherë të gjitha fazat e mësipërme dhe në rast se preventivi i projekt-zbatimit do të ketë vlerë të barabartë apo më të madhe se 100,000,000 lekë më t.v.sh., projekti do t'i nënshtrohet oponencës teknike të Institutit të Ndërtimit, sipas afateve përkatësë. (të miratuara përkatësisht nga Këshilli Teknik i Drejtorisë së Përgjithshme të Punëve Publike).

Ne afatet e dorëzimit përfshihet dhe koha 1 javore per komentet e klientit për secilën fazë.

Dorëzimi i dokumentacionit do të bëhet në rrugë zyrtare shoqëruar me fletë inventari. Të gjitha dokumentat e printuara duhet të jenë të firmosura e vulosura në origjinal nga të gjithë projektuesit.

Materialet dorëzohen në 5 kopje format hard copy (të printuar) dhe 5 cd (4 cd në format soft copy cad,exel,word etj, dhe 1 cd në format pdf)

Gjithashtu do dorëzohet versioni i dixhitalizuar i cili transferohet në GIS.

10. Investimi Themelor

Investimi themelor do të dalë nga varianti më i mirë i miratuar nga Këshilli Teknik i Bashkisë së Tiranës.

11. Sqarime të fundit

Projektuesi është përgjegjës të sigurojë saktësinë dhe pajtueshmërinë me të gjitha standardet dhe normat përkatëse.

Të dhënat e nevojshme për projektim, sikurse janë: gjendja e rrjetit ekzistues të ujësjellësit, të kanalizimeve, ndriçimit, kabinat e tensionit të lartë, vendosja e kontenierëve, planin rregullues të zonës, etj, do të merren nga projektuesi sipas formularëve përkatës.

Shpërndarja:

Vendi dhe dorëzimi i shërbimeve:**Bashkia Tirane**

**Shtojca 16**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*]

## NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR[6]

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" .

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u skualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

______________________________________________________________________
______________________________________________________________________
______________________________________________________________________
______________________________________________________________________
______________________________________________________________________
______________________________________________________________________
______________________________________________________________________

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi sic parashikohet në Kreun VII të LPP.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt
**< Emri >**

**Shtojca 17**

[6] Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT**

[Data________]

Për: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]*

Procedura e prokurimit:
Numri i referencës së procedurës/lotit:
Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]*
Publikime të mëparshme *(nëse zbatohet):* Buletini i Njoftimeve Publike *[Data] [Numri]*

* * *

Lista e operatorëve ekonomikë të kualifikuar në përfundim të fazës së parë të procedurës së sipërcituar:

1.___________________________________ ______________________________
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

2.___________________________________ ______________________________
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*
Etj.

* * *

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës nëfazat e tjera të procedurës së sipërcituar këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1.___________________________________ ______________________________
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*
Vlera ______________________________
*(me numra dhe fjalë)*

2.___________________________________ ______________________________

*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*
Vlera ___________________________
*(me numra dhe fjalë)*
Etj.

Janë skualifikuar operatorët ekonomikëtë mëposhtëm:
1.______________________________ ___________________________
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*
2.______________________________ ___________________________
*Emri i plotë i shoqërisë numri i NIPT-it*
Etj.
Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

---

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë ***[emri, Nipti dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]*** se oferta e paraqitur nga ana juaj dhe e vlerësuar me ______pikë, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *[emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit]* sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _________nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) siç parashikohet në nenin 49 të ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë ____________________

Ankesa: ka ose jo_____________
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _______________________

**[Titullari i autoritetit kontraktor]**

**Shtojca 18**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër*]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR**

*[Data]*

Për: *[Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]*

1. ________________________________________
*2.* ________________________________________
*3.*________________________________________

* * *

Procedura e prokurimit: ______________________
Numri i referencës së procedurës/lotit:
Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]*
Publikime të mëparshme *(nëse zbatohet):* Buletini i Njoftimeve Publike *[Data] [Numri]*
Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: ☐ oferta ekonomikisht më e favorshme ☐çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatoren e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1.________________________________ ____________________________
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera ____________________________
*(me numra dhe fjalë)*

2.________________________________ ____________________________
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera ___________________________
*(me numra dhe fjalë)*

Etj.____

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1.___________________________________ ________________________________
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*
2.___________________________________ ________________________________
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:
___________________________________________________________________________________
___________________________________________________________________________________
___________________________________________________________________________________

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se jane identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:
1.___________________________________ ________________________________
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera ________________/ Pikët totale të marra ____
*(me numra dhe fjalë)*
2.___________________________________ ________________________________
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera ___________/Pikët totale të marra ____
*(me numra dhe fjalë)*
Etj.__

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë *[emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit]*, brenda ____________ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë ______________________________

Ankesa: ka ose jo______________
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë ____________________________

**[Titullari i autoritetit kontraktor]**

**Shtojca 19**

## KUSHTET E PËRGJITHSHME TE KONTRATES
### Shërbimet e Konsulencës

### Neni 1 Qëllimi

i Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për Shërbimet e Konsulencës.

i Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërise parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.

i Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.

i KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.

Kushtet e kontratës, përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

### Neni 2 Përkufizime

i "Kontratë" do të thotë marrveshja e shkruar e lidhur midis Blerësit Publik dhe Kontraktuesit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.

i "Cmim kontrate" do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.

i "Objekt i kontratës" do të thotë të gjitha Shërbimet që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.

i "Palë (t)" do të thotë nënshkruesit e kontratës.

i "Autoriteti Kontraktor" do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen sherbimin. Ky term kudo qe përdoret ka kuptim të njëjtë me ate te perkufizuar ne ligj.

i "Kontraktues" do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate shet Shërbimet.

i "Shërbime" do të thotë të gjitha detyrat që do të kryhen nga Kontraktuesi sipas kontratës.

i "Termat e References" shprehin objektin dhe qëllimin e kontratës, përcaktojne detyrat, kërkesat, objektivat, shpërndarjen, vendin dhe dorëzimin e Shërbimeve që do të sigurohen.

**Neni 3 Hartimi i Kontratës**

i Shpallja e fituesit do të sherbejë per hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në dokumentat e tenderit.

i Egzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke materializuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

**Neni 4 Praktikat Korruptive, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve**

i Autortiteti Kontraktues mund t'i kërkojë Gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën në se zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.

i Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose njësi që ka marrë pjesë në pregatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.

i Kontraktuesi është dakort që të përjashtojë veten e tij nga prokurimi i mallrave, shërbimeve ose ndertimeve që mund të pasojnë, si rezultat i, ose në lidhje me, këtë kontratë.

i Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktues të inspektojë llogaritë dhe procesverbalet që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t'i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktues.

**Neni 5 Informacioni Konfidencial**

i Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktor duhet të mbajnë në kofidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.

i Kontraktuesi mund t'i japë nenkontraktuesit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktues deri në masën e kërkuar për nën-kontraktuesin në mënyrë që ai të kryejë punën e tij sipas kontatës. Në rast të tillë, Kontraktuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktuesin një dispozitë që premton ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

**Neni 6 Prona Intelektuale**

i Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga Kontraktuesi gjatë Kontrates do t'i përkasin Autoritetit Kontraktues i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.

i Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, Furnizuesi, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i dorëzojë Autoriteti Kontraktues të gjitha raportet dhe të dhënat si

hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose pregatitura nga Kontraktuesi gjatë kontratës. Kontraktuesi mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, por nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktues.

i Kontraktuesi duhet të sigurojë Autoritetin Kontraktues nga mospërgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale që mund të dalin nga prodhimi ose kryerja e Shërbimeve sipas kontratës.

i Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoriteti Kontraktues në lidhje më ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i gjërave të furnizuara sipas kontratës, Kontraktuesi duhet t'i japë Autoriteti Kontraktues të gjitha provat dhe informacionin në posedim të Kontraktuesit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

**Neni 7 Detyrimet e Përgjithshme të Kontraktuesit**

i Kontraktuesi duhet t'i kryejë Shërbimet dhe përmbushi detyrimet e tij me të gjitha përpjekjet, eficiente dhe ekonomike në pajtim me teknikat dhe praktikat profesionale te pranuara ne përgjithsi.

i Kontraktuesi duhet të ndjekë praktika të shëndosha të biznesit dhe të përdorë teknologji të avancuar dhe të përshtatshme si dhe metoda të sigurta.

i Në se kontrata kërkon kryerjen e shërbimeve këshillimore profesionale, Kontraktuesi duhet të veprojë gjithmonë si një këshillues besnik i Autoriteti Kontraktues, në pajtim me rregullat dhe kodin e sjelljes të profesionit të tij dhe duhet që të mbështesi dhe ruajë gjithmonë interesin publik.

i Në se kontrata kërkon kryerjen e shërbimeve këshillimore profesionale, Kontraktuesi duhet të ushtrojë kujdes të plotë në mardhëniet me palët e treta duke përfshirë median dhe nuk duhet të marrë pjesë në veprime që janë jashte kompetences së tij në përfaqsimin e Autoritetit Kontraktues.

**Neni 8 Detyrimet e Veçanta të Kontraktuesit**

i Kontraktuesi duhet të kryejë të gjitha Shërbimet siç specifikohet tek Termat e References.

i Kontraktuesi duhet t'i paraqesë Autoritetit Kontraktues të gjitha sherbimet, në sasitë e përcaktuara, siç kërkohen nga kontrata duke përfshirë, por jo të kufizuara nga, të gjitha raportet, dokumentat, studimet, skicimet dhe planimetritë.

i Kontraktuesi duhet të sigurojë raportet e lidhura me zbatimin e Shërbimeve siç kërkohet në kontratë.

**Neni 9 Specifikime dhe Skicime**

i Në se kontrata kërkon shërbime skicimi, Kontraktuesi duhet të pregatisi të gjitha specifikimet dhe skicimet duke përdorur sisteme të pranuara dhe të njohura në përgjithsi të pranueshme për Autoritetet Kontraktues dhe të marri parasysh standartet më të fundit.

i Nëse kontrata kërkon shërbime skicimi, Kontraktuesi duhet të sigurojë se të gjitha specifikimet, skicimet dhe kërkesat e tjera janë pregatitur në bazë asnjanëse përsa i përket nxitjes së konkurencës në prokurimin e objekteve të skicimit.

**Neni 10 Lejet dhe Liçensat**

i Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për sigurimin e lejeve ose liçensave sipas kërkesave të Ligjeve të Republikës së Shqipërisë për kryerjen e Shërbimeve në këtë kontratë vec rastit kur palet bien dakord ndryshe.

**Neni 11 Heqja dhe Zëvendësimi i Personelit Kryesor**

i Kontraktuesi duhet të sigurojë aprovim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues përpara heqjes ose zëvendësimit të personelit kryesor siç përshkruhet në oferten e Kontraktuesit.

i Kontraktuesi do të zëvendësojë çdo punonjës në se Autoriteti Kontraktues zbulon se personi ka kryer veprime të jashtëligjshme ose Autoriteti Kontraktues është mjaft i pakënaqur nga puna e personit.

i Nëse bëhet e nevojshme të zëvendësohet ndonjë nga personeli kryesor, Kontraktuesi duhet të sigurojë si zëvendësues një person me kualifikime ekuivalente ose më te mira.

i Kontraktuesi do të paguajë kosto shtesë për zëvendësimin e personelit kryesor me përjashtim kur shkaku i zëvendësimit ka ardhur nga neglizhenca ose mungesa e kujdesit të Autoriteti Kontraktues.

**Neni 12 Vendndodhja**

i Shërbimet duhet të kryhen në vendin ose vendet e specifikuara në kontratë.

i Në se nuk është specifikuar vendi, Autoriteti Kontraktues rezervon të drejtën të aprovojë vendin ose vendet e kryerjes së Shërbimeve, megjithatë, aprovimi nuk duhet të vonohet ne mënyrë të paarsyeshme.

**Neni 13 Siguracioni i Përgjegjësisë Profesionale**

i Kontraktuesi duhet të mbajë siguracion për përgjegjësi profesionale sipas rregullave dhe praktikave të njohura në përgjithsi për profesionin për ta zhdëmtuar Autoriteti Kontraktues për dëme të rezultuara nga neglizhenca, gabimet ose mangësitë, në kryerjen e Shërbimeve.

i Nëse nuk është përcaktuar në kontratë shuma minimale e siguracionit, Kontraktuesi duhet të sigurojë siguracion në shumën e njohur në përgjithsi si të mjaftueshme nën rrethanat e

Shërbimeve që po sigurohen.

**Neni 14 Çmimi i Kontratës**

i Çmimi i kontratës duhet të jetë çmimi i ofruar në oferten e Kontraktuesit dhe i pranuar nga Autoriteti Kontraktues.

**Neni 15 Afatet e Pagesës**

i Çmimi i kontratës, duke përfshirë çdo pagesë paraprake, duhet të paguhen në kohë siç specifikohet në kontratë.

i Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në kontratë, pagesa duhet bërë në monedhë Shqiptare. Kursi i shkëmbimit i monedhave të ndryshme do të jetë kursi i Bankes se Shqiperise në ditën kur është dërguar njoftimi i kontratës për botim.

i Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në kontratë, kërkesa e Kontraktuesit për pagesë duhet t'i bëhet Autoriteti Kontraktues me shkrim. Për çdo kërkesë, Kontraktuesi duhet të paraqesë origjinalin dhe kopjen së bashku me një listë të sendeve që përshkruan shërbimet e kryera për të cilat duhet paguar.

i Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në kontratë, pagesa për shërbimet do të bëhet brenda 30 ditëve kalendarike nga dita qe janë kryer Shërbimet, dorëzimi është paraqitur ose arritur, ose nga dita e marrjes së kërkesës për pagesë cilado të jetë më e vonë.

i Data e pagesës do të jëte dita që fondet debitohen nga llogaria e Autoritetit Kontraktues.

**Neni 16 Vonesa në Bërjen e Pagesës**

Në rast të verifikimit të vonesave në kryerjen e pagesave nga ana e Autoritetit Kontraktor, megjithëse kontraktuesi ka përmbushur të gjitha detyrimet e tij në përputhje me kushtet e kontratës, detyrimet e prapambetura dhe kamatëvonesat përkatëse do të kryhen në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare

**Neni 17 Ndryshimi i Ligjeve dhe Rregulloreve**

Nëse pas datës së dorëzimit të ofertave ose datës së nënshkrimit të kontratës, ndonjë ligj ose akt nënligjor në Republikën e Shqipërisë hyn në fuqi ose ndryshon dhe ndikon kushtet, duke përfshirë datën e dorëzimit ose çmimin e kontratës, kushtet ose çmimi i kontratës do të rregullohen në atë masë sa kontraktuesi është ndikuar në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës.

### Neni 18 Forca Madhore

i Kontraktuesi nuk duhet të mbajë përgjegjësi për humbjen e depozitës së kontrates, dëmet e likuiduara ose ndërprerjen për mosplotësim nëse dhe deri në masën që vonesa në zbatim ose ndonjë dështim tjetër në zbatimin e detyrimeve të tij sipas kontratës vijnë si rezultat i ndodhjes së Forcës Madhore.

i Për qëllimet e këtij neni "Forcë Madhore" do të thotë një ngjarje e paparashikueshme jashtë kontrollit të Kontraktuesit mbi fajin ose neglizhimin. Ngjarje të tilla mund të përfshijnë, por nuk janë të limituara nga, veprimet e Autoritetit Kontraktues qoftë në kapacitetin e tij sovran ose kontraktual, lufta ose revolucionet, zjarri, përmbytja, tërmeti, epidemitë, shtrëngime të karantinës dhe embargo tranziti.

i Në se ndodh ndonjë situatë e Forcës Madhore, Kontraktuesi duhet të njoftojë menjehere Autoriteti Kontraktues. Me përjashtim kur Autoriteti Kontraktues jep direktiva të ndryshme, Kontraktuesi duhet të vazhdojë të zbatojë detyrimet e tij sipas kontratës në masën praktikisht të arsyeshme dhe duhet të kërkojë të gjitha mjetet e arsyeshme për zbatimin që nuk pengohet nga Forca Madhore.

### Neni 19 Vonesa në Zbatim dhe Zgjatja e Afatit

i Me përjashtim kur parashikohet ndryshe, Kontraktuesi duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë pas nënshkrimit të saj.

i Me përjashtim të rastit kur Autoriteti Kontraktues është dakord për zgjatje të afatit të kontratës, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të likuidojë dëmet për vonesën në zbatim nëse Kontraktuesi dështon në kryerjen e Shërbimeve brenda periudhës së Kontrates.

i Autoriteti Kontraktues mund të zbresë shumën e dëmeve të likuiduara që duhet paguar nga shuma e pagesës ndaj Kontraktuesit. Në rast të tillë Autoriteti Kontraktues duhet t'i japi kontraktuesit njoftim me shkrim për shumën dhe arsyen e zbritjes.

i Autoriteti Kontraktues do të jetë dakort për një zgjatje të afatit në rastin e Forcës Madhore.

i Autoriteti Kontraktues mund të jetë dakort për zgjatje të afatit edhe në rrethana të tjera nëse është në interesin publik për ta bërë këtë. Ne rast se Kontraktuesi ndeshet me kushte që pengojnë zbatimin në kohë, Kontraktuesi duhet të njoftojë menjehere Autoritetin Kontraktor me shkrim për vonesën, shkakun dhe datën e propozuar të përfundimit të Shërbimeve. Autoriteti Kontraktor duhet të vlerësojë kërkesën. Nëse Autoriteti Kontraktor është dakort me vonesën, zgjatja do të hyjë në fuqi me një amendament me shkrim të kontratës të nënshkruar nga Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktuesi.

### Neni 20 Likuidimi i Dëmeve për Dorëzimin e Vonuar

i Dëmet e likuidueshme për kryerjen e vonuar të Shërbimeve do të llogariten me tarifat e

mëposhtme ditore:

- i Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë 4/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.
- i Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 2/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.
- i Për kontratat me periudhë zbatimi më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 1/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.

**Neni 21 Negociatat dhe Amendamentet**

i Palët nuk do të negociojnë ndryshime ose amendamente të asnjë elementi të kontratës që do të ndryshonte mjaftueshëm kushtet që përbëjnë bazën e përzgjedhjes së Kontraktuesit.

i Asnjë amendament ose variacion tjetër i kontratës nuk do të jetë i vlefshëm pa qënë me shkrim, me datë, t'i referohet shprehimisht kontratës dhe nënshkruhet nga një përfaqsues i autorizuar i Kontraktuesit dhe Autoritetit Kontraktor.

i Çdo heqje dore nga të drejtat, pushtetet ose ndreqjet që mund të bëhen nga palët sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim, të ketë datë dhe të firmoset nga një përfaqsues i autorizuar i palës që bën këtë dorëheqje dhe duhet të specifikojë të drejtën dhe masën në të cilën ajo lëshohet.

**Neni 22 Ndryshimi i Porosisë**

i Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të porosisë Shërbime shtesë deri në një sasi që nuk i kalon 20% të çmimit total të kontratës. Çdo porosi shtesë duhet të bëhet në mënyrë konsistente me rregullat dhe procedurat e parashikuara në Ligjin mbi Prokurimin Publik.

**Neni 23 Ndërprerja për Mosplotësim**

i Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në tërësi ose pjesërisht nëse:

- i Kontraktuesi dështon të kryejë Shërbimet brenda periudhës së specifikuar në kontratë ose brenda zgjatjes së dhënë; ose,
- i Kontraktuesi dështon të zbatojë ndonjë detyrim tjetër të kontratës.

i Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi Kontraktuesit njoftim me shkrim për ndërprerjen për mosplotësim dhe t'i japi Kontraktuesit 15 ditë të ndreqë mosplotësimin me përjashtim kur ndërprerja është bërë për veprime korruptive ose të paligjshme, rast në të cilin ndërprerja do të jetë e menjëhershme.

**Neni 24 Ndërprerja për Shkak të Falimentimit**

i Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse Kontraktuesi falimenton ose bëhet i paaftë të paguajë.

i Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi Kontraktuesit njoftim me shkrim për ndërprerjen.

**Neni 25 Ndërprerja për Shkak të Interesit Publik**

i Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse gjykon se ky veprim duhet ndërmarrë për t'i shërbyer sa më mirë interesit publik.

i Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi Kontraktuesit lajmërim me shkrim për ndërprerjen.

i Autoriteti Kontraktor duhet të paguajë Kontraktuesin për të gjitha Shërbimet e kryera përpara ndërprerjes dhe duhet t'i paguajë Kontraktuesit dëmet e shkaktuara për kryerjen e pjesshme të Shërbimeve. Në llogaritjen e shumës së dëmeve, Kontraktuesi do të kërkohet të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të minimizuar dëmet.

**Neni 26 Nënkontrata**

i Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është në formën e një marrveshjeje të shkruar me anë të së cilës kontraktori i beson kryerjen e një pjese të detyrimeve të kontratës së tij një pale të tretë

i Kontraktori nuk duhet të nënkontraktojë pa aprovimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktor dhe jo më shumë se 40% të vlerës së kontratës. Kontraktori duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktor për elementet e kontratës që nënkontraktohet dhe dokumentacionin që provon aftësine e nënkontraktorit. Autoriteti Kontraktor duhet të lajmërojë kontraktorin për vendimin e tij, brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke shprehur arsyet nëse e aprovon apo jo atë.

i Cdo nenkontraktor duhet të kete te drejte te marre pjese ne prokurimin publik sipas Ligjit mbi Prokurimin Publik. Autoriteti mund të parashikojë pagesa direkte tek nënkontraktori për shërbimet që do të furnizojë.

i Kur Kontraktuesi ka ndër mend të realizoje një pjesë të punimeve me nën-kontraktues, duhet të paraqesë në ofertë, sipas dokumentave të tenderit, gjithë dokumentacionin e kerkuar per nenkontraktuesin si dhe punimet konkrete qe do te jape me nensipermarrje.

i Kontraktori mbetet plotësisht përgjegjës për zbatimin e kontratës pamvarësisht nga sjellja e nenkontraktorit.

**Neni 27 Transferimi i të Drejtave**

i Kontraktuesi nuk duhet të transferojë, tërësisht ose pjesërisht, detyrimet e tij sipas kontratës me përjashtim kur jepet miratimi paraprak i Autoritetit Kontraktor.

**Neni 28 Sigurimi i Kontrates**

i Përpara nënshkrimit të kontratës, kontraktuesi duhet t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktor sigurimin e kontrates në shumën dhe formën e kërkuar

- Shuma e sigurimit të kontrates duhet t'i paguhet Autoritetit Kontraktor si kompensim për çdo humbje të rezultuar nga dështimi i Kontraktuesit në plotësimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.

- Sigurimi i kontrates do t'i kthehet Kontraktuesit jo më vonë se 30 ditë pas datës së kryerjes së Shërbimeve.

**Neni 29 Baza Ligjore**

- Kontrata do të rregullohet nga dispozitat e legjislacionit shqiptar në fuqi.

**Neni 30 Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve**

- Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktuesi duhet të bëjnë çdo përpjekje të zgjidhin mosmarrëveshjet ose konfliktet e ndodhura midis tyre ose në lidhje me këtë marrëveshje me negociata direkte.

- Nëse palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshjes ose konfliktit, problemet do të konsiderohen me anë të zgjidhjes së marrëveshjeve sipas kontratës dhe procedurave juridike në fuqi sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.

**Neni 31 Përfaqësimi i Palëve**

- Çdo palë duhet të emërojë me shkrim një person ose post organizativ, që do të jetë përgjegjës, në emër të palës, për marrjen e komunikatave dhe për përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me egzekutimin e kontratës.

- Secila palë duhet të lajmërojë palën tjetër menjëherë për ndonjë ndryshim në emërimin e përfaqsuesit të palës. Nëse njëra palë dështon të lajmërojë, duhet të marri përsipër çdo humbje të shkaktuar nga dështimi për të dhënë njoftim të mjaftueshëm.

- Palët mund të emërojnë persona ose njësi organizative shtesë për të përfaqsuar palën në veprime ose veprimtari të veçanta njoftimi me shkrim në të cilin rast duhet dhënë dhe duhet të përcaktoje shtrirjen e autoritetit të përfaqsuesit.

**Neni 32 Lajmërimet**

- Çdo lajmërim i dhënë nga njëra palë tjetrës sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim në adresën e specifikuar në kontratë.

- Njoftimi do të ketë efekt sapo të dorëzohet.

**Neni 33 Llogaritja e Afateve**

- Të gjitha referencat e ditëve do të jenë ditë kalendarike me përjashtim kur parashikohet ndryshe.

**Shtojca 20**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*]

## KUSHTET E VEÇANTA TE KONTRATES
## Shërbimet e Konsulencës

Kushtet e veçanta të Kontratës hartohen në përputhje me objektin konkret të kontratës. Në rast se ka mospërputhje midis KPK dhe KVK do të mbizotërojne Kushtet e veçanta të kontratës

**Neni 1 Përkufizime**

i Autoriteti Kontraktor është ___________________________________________________

i Kontraktuesi është ________________________________________________________

**Neni 2 Sigurimi i kontrates**

i Sigurimi i kontrates në shumën prej (10 % te vleres se kontrates) duhet të ofrohet nga Kontraktuesi për të siguruar egzekutimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.

i Sigurimi i kontrates do t'i lëshohet ose kthehet, menjehere, Kontraktuesit sipas formularit të mëposhtëm:
_______________________________________________________________________
_______________________________________________________________________
_______________________________________________________________________

**Neni 3 Fillimi i Kontrates**

i Zbatimi i kontratës duhet të filloje më __________. Nëse nuk është specifikuar, zbatimi do të fillojë në datën që Kontraktuesi nënshkruan formularin e kontratës.

**Neni 4 Vendndodhja e Shërbimeve**

i Shërbimet do të kryhen në: ______________________________________________

**Neni 5 Informacion që duhet dhënë nga Autoriteti Kontraktor**

i Brenda 15 ditësh nga marrja e sigurimit te kontrates, Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi Kontraktuesit informacionin dhe dokumentat e mëposhtme: ________________________
_______________________________________________________________________
_______________________________________________________________________
_______________________________________________________________________
_______________________________________________________________________
_______________________________________________________________________

**Neni 6 Kërkesat e Raportimit**

i Gjatë zgjatjes së kontratës, Kontraktuesi duhet të sigurojë raporte për Autoritetin Kontraktor sipas formularit të mëposhtëm:
________________________________________________________________________
________________________________________________________________________
________________________________________________________________________

**Neni 7 Siguracioni i Përgjegjësisë Profesionale**

i Përpara fillimit të zbatimit të kontratës, Kontraktuesi duhet të siguroje Autoritetin Kontraktor me prova për siguracionin e përgjegjsisë profesionale me shumë minimale si vijon:
________________________________________________________________________
________________________________________________________________________
________________________________________________________________________

**Neni 8 Kushtet e Pagesës**

i Pagesa për Shërbimet duhet bërë sipas skedarit të mëposhtëm: _________________
________________________________________________________________________
________________________________________________________________________
________________________________________________________________________

i Çdo pagesë e skeduar duhet bërë brenda _________ ditëve nga data e arritjes së marrveshjes për pagesën ose nga data e marrjes së kërkesës me shkrim për pagesë cilado që të jetë më vonë. Nëse është lënë e paplotësuar, periudha kohore do të jetë 30 ditë.

i Monedha e pagesës do të jetë ______. Nëse është lënë e paplotësuar, pagesa do bëhet me monedhën Shqiptare.

**Neni 9 Pagesa Paraprake**

i Përqindja e pagesës paraprake do të jetë _____. Nëse është lënë e paplotësuar, Kontraktuesi nuk do të marrë pagesë paraprake.

i Nëse është premtuar një pagesë paraprake, avanca do të paguhet brenda ______ ditëve nga marrja e sigurimit te kontrates.

i Nëse jepet pagesa paraprake, shuma do të hiqet nga pagesa që duhet t'i jepet Kontraktuesit sipas formulës së mëposhtme: ______________________________________________
________________________________________________________________________

**Neni 10 Zbritja e garancisë së kontratës**

10.1 Nëse parashikohet zbritje periodike të garancisë së kontratës ajo kryhet si më poshtë
______________________________________________________________________
______________________________________________________________

Nëse nuk plotësohet, garancia mbetet e pandryshuar.

**Shtojca 21**

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

**FORMULARI I PUBLIKIMIT TË NJOFTIMIT TË KONTRATËS SË NËNSHKRUAR**

i**Autoriteti Kontraktor**

**I.1 Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor**

Emri ______________________________________________

Adresa ______________________________________________

Tel/Fax ______________________________________________

E-mail ______________________________________________

Adresa në Internet ______________________________________________

**I.2 Lloji i autoritetit kontraktor:**

Institucion Qëndror ☐ Institucion i Pavarur ☐

Njësi e Qeverisjes Vendore ☐ Tjetër ☐

**Seksioni 2Objekti i Kontratës**

**2.1 Numri i referencës së procedurës/lotit__________**

**2.2 Lloji i "Kontratave Publike për Shërbime"**

Konkurs Projektimi ☐ Shërbime Konsulence ☐ Shërbime të tjera ☐

**2.2.1 Kontratë në bazë të Marrëveshjes Kuader**

**Nëse Po, lloji i Marreveshjes Kuadër**

**Me 1 Operator Ekonomik** ☐

**Me disa operatorë ekonomikë** ☐

**Të gjitha kushtet janë të përcaktuara**

**2.3 Përshkrim i shkurtër i kontratës**

1 Fondi limit ______________________________________________

2. Burimi i Financimit ______________________________________

3. Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër________________________________________

**2. 4 Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin:**

Kohëzgjatja në **muaj** □□□**ose ditë** □□□□

ose

duke filluar nga □□/□□/□□□□ me përfundim në □□/□□/□□□□

**2.5 Ndarja në LOTE:**

Po □ Jo □

*Nëse Po,* numri i LOTEVE*:* □□

**2.6 Opsionet:**

Numri i rinovimeve të mundshme(nëse ka): □□

ose: nga□□në□□□□□

**<u>2.7 Kontrate me </u>nenkontraktim:**

Po □ Jo □

**Seksioni 3<u>Procedura</u>**

**3.1 Lloji i procedurës:**Shërbim Konsulence

**3.2 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:**

**Oferta më e mirë bazuar në:**

Çmimi □□ Propozimi teknik □□

**3.3 Numri i kërkesave të dorëzuara:** □□□ **Numri i kërkesave të rregullta:** □□□

**3.3.1 Numri i propozimeve të dorëzuara** □□□**Numri i propozimeve të rregullta**□□□

**Seksioni 4 Informacion mbi kontratën**

**4.1 Numri i Kontratës: _______________Data e Kontratës** □□/□□/□□□□

**4.2 Emri dhe adresa e kontraktorit**

Emri ____________________________________________

Adresa ____________________________________________

Tel/Fax ____________________________________________

E-mail ____________________________________________

Adresa e Internetit ____________________________________________

4.2.1**Emri dhe adresa e nenkontraktorit/eve**

Emri ____________________________________________

Adresa ____________________________________________

Tel/Fax ____________________________________________

E-mail ____________________________________________

Faqja e Internetit ____________________________________________

**4.3 Vlera totale përfundimtare e kontratës** *(duke përfshirë lotet, opsionet dhe nenkontraktimin)*:

Vlera _______________ *(pa TVSH)* Monedha __________

Vlera _______________ *(me TVSH)* Monedha __________

4.3.1 Vlera totale **e nenkontraktimit : ____**

Vlera _______________ *(pa TVSH)* Monedha __________

Vlera _______________ *(me TVSH)* Monedha __________

## 4.4 Informacione shtesë

______________________________________________________________________

________________________________________________

Data e shpërndarjes së këtij njoftimi □□/□□/□□□□

**Shtojca 22**

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor për publikim në Buletinin e Njoftimeve Publike]

**1.Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor**

Emri ______________________________________________

Adresa ______________________________________________

Tel/Fax ______________________________________________

E-mail ______________________________________________

Faqja në Internet ______________________________________________

**2. Lloji i procedurës: ______________________________________________**

**3. Numri i referencës së procedurës/lotit__________________________**

**4. Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër_______________________**

**5. Fondi limit ______________________________________________**

**6. Vlera totale përfundimtare e kontratës** *(duke përfshirë lotet opsionet dhe nenkontraktimin)*:

Vlera _______________ *(me TVSH)* Monedha __________

Vlera e nenkontraktimit______________*me Tvsh*Monedha __________________

**7. Data e lidhjes së kontratës____________**

**8. Emri dhe adresa e kontraktorit/nenkontraktorit**

Emri ______________________________________________

Adresa ______________________________________________

Nr. NIPT ______________________________________________

**Shtojca 23**

**FORMULAR PËR NJOFTIMIN E ANULIMIT TË PROCEDURËS SË PROKURIMIT**

**1.Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor**

Emri ______________________________________________

Adresa ______________________________________________

Tel/Fax ______________________________________________

E-mail ______________________________________________

Faqja në Internet ______________________________________________

1. **Lloji i procedurës:** _______________________________________

2. **Numri i Referencës:** _______________________________________

3. **Objekti i kontratës** _______________________________________

4. **Fondi limit** _______________________________________

5. **Arsyet e Anulimit:**

Bazuar në Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, neni 24, pika 1:

**a)** ;
**b)** ;
**c)** ;
**ç)** ;
**d)** ;
**dh)** ;

**Etj.** _______________________________________

**6. Informacione shtesë**

_______________________________________________________________

Data e shpërndarjes së këtij njoftimi _

**Shtojca 24**

[*Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve*]
[*Shtojcë për t'u paraqitur nga Operatori Ekonomik*]

## FORMULARI I SIGURIMIT TË KONTRATËS

[Data ________

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]*
Ne Emer te: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

Procedura e prokurimit: *[lloji i procedurës ]*
Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[objekti]*
Publikimi *(nëse zbatohet):* Buletini i Njoftimeve Publike *[Data] [Numri]*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, dhe me kusht që [*emri i ofertuesit të përcaktuar fitues*] t'i jetë akorduar kontrata,

Ne vërtetojmë se [*emri i ofertuesit të përcaktuar fitues*] ka derdhur një depozitë pranë [*emri dhe adresa e bankës / kompanisë së sigurimeve*] në një shumë prej [*monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra*] si kusht për sigurimin e ekzekutimit të kontratës, që do të nënshkruhet me [*emri i autoritetit kontraktor*]

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [*emri i autoritetit kontraktor*] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mos përmbushjen e kushteve të kontratës.

Ky Sigurim është i vlefshëm deri në zbatimin e plotë të kontratës.

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimeve]

**Shtojca 25.**

## FORMULARI I ANKESËS PRANE AUTORITETIT KONTRAKTOR

***Ankesë drejtuar:*** ***Autoriteti Kontraktor***

### Seksioni I. Identifikimi i Ankimuesit

*Ankimuesi mund të jetë një ofertues ose ofertues i mundshëm (psh, si individ, në partneritet, në bashkëpunim, në bashkim shoqërish).*

Emri i plotë i ankimuesit (ju lutem shtypeni)

Adresa

Qyteti | Shteti | Kodi Postar/Kodi Zip

Nr. Telefoni (duke përfshirë edhe prefiksin e zonës) | Nr. Faksi (duke përfshirë edhe prefiksin e zonës)

Email

Emri dhe pozicioni i zyrtarit të autorizuar që plotëson ankesën (ju lutem, shtypeni)

Firma e zyrtarit të autorizuar | Data (viti/muaji/dita)

Nr. Telefoni (duke përfshirë prefiksin e zonës) | Nr. Faksi (duke përfshirë prefiksin e zonës)

### Seksioni II. Informacion për Procedurën

**1. Numër Identifikimi**

*Plotësoni numrin e kontratës në njoftimin e kontratës ose në dokumentat e tenderit, duke përfshirë* ***llojin e procedurës së përdorur*** *për prokurimin në fjalë (psh, Kërkesë për Propozime(KP), Procedurë e Hapur(PH), Procedurë e Kufizuar(PK), Procedurë me Negociim(PN), Shërbim Konsulence (SHK), Konkurs Projektimi (KP).*

______________________________________________

**2. Autoriteti Kontraktor**
*Emri i autoritetit kontraktor që administron procesin e prokurimit.*

______________________________________________

**3. Vlera e Përllogaritur e Prokurimit**
*Llogaritja e vlerës së kontratës (shuma e shprehur në shifra dhe fjalë)*

______________________________________________

**4. Objekti i Kontratës**
*Përshkrim i shkurtër i punëve/mallrave/shërbimeve që blihen.*

______________________________________________

**5. Afati Përfundimtar për Dorëzimin e Ofertës**
*Afati përfundimtar për dorëzimin e ofertave.*

______________________________________________
Data (viti/muaji/dita)

**6. Data e Përcaktimit të Kontratës Fituese**

______________________________________________
Data (viti/muaji/dita) nëse zbatohet

**Seksioni III. Përshkrimi i ankesës**

**1. Baza Ligjore e Ankesës**
(shkruani shkeljen ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumenta, etj)

______________________________________________

**2. Deklaratë e Hollësishme e Fakteve dhe Argumenteve**

*Jepni një deklaratë të hollësishme të fakteve dhe argumenteve që mbështesin ankesën tuaj. Për çdo arsye të ankesës specifikoni datën në të cilën u vutë në dijeni për faktet e lidhura me arsyet e ankesës. Përmendni edhe seksionet perkatëse të dokumentave të tenderit, nëse zbatohen. Përdorni faqe shtesë, nëse është e nevojshme.*

**3. Lista e Shtojcave**

*Që një ankesë të konsiderohet e dorëzuar, ajo duhet të jetë e plotë. Bashkangjisni një kopje të lexueshme të të gjithë dokumentave që kanë lidhje me ankesën tuaj dhe një listë të të gjithë këtyre dokumentave. Dokumentat duhet të përfshijnë normalisht* ***çdo njoftim të publikuar, të gjitha dokumentat e tenderit, me të gjitha ndryshimet dhe shtojcat, propozimin tuaj .*** *Përcaktoni se cili prej informacioneve është konfidencial, nëse ka të tillë. Shpjegoni se përse informacioni është i tillë, ose dorëzoni një version të dokumentave përkatëse me pjesët konfidenciale të hequra dhe një përmbledhje të përmbajtjes.*

---

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës për prokurimin, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe disa kopje shtesë, pranë **autoritetit kontraktor**

Shënim: Për ankesat pranë Komisionit të Prokurimit Publik duhet ti referoheni Formulari të Ankesës se nxjerrë nga ky institucion.

**Nr. Faks:**
**E-mail:**

**Nenshkrimi dhe Vula e ankuesit**

**Shtojca 26**

**DRAFTI I MARRËVESHJES KUADËR**
( ku te gjitha kushtet janË tË pËrcaktuara)
**PER PUNË / MALLRA / SHËRBIME**

[Përdorimi i ketij draft marrëveshje është detyruese për të gjitha Autoritetet Kontraktore që do të përdorin marrëveshjen kuadër)

**Nr __**
**DATA:**

Kjo kontratëlidhet [*data*], midis [*emri dhe adresa e Autoritetit Kontraktor*] tani e tutje të referuar si "Autoriteti Kontraktor" dhe [*emri dhe adresa e Kontraktuesit*] të përfaqësuar nga [*përfaqësuesi*], tani e tutje i quajtur si "Kontraktuesi".

Kontraktori, me anë të ofertës së tij, me datë [*data*] bie dakord të furnizoje mallrat, ashtu siç janë të specifikuara në kushtet e përcaktuara në:

- Këtë kontrate
- Formulari i Deklarimit te Ofertës, të paraqitur nga Ofertuesi
- Specifikimet Teknike
- Formulari i çmimit të ofertës

Të gjitha këto dokumenta të bashkangjitur përbëjnë pjesë integrale të kësaj kontrate.

**Neni 1 Objekti**

1.1 Objekti i marreveshjes kuadër është të përcaktojë kushtet, përfshirë çmimet per njësi dhe rregullat për dorëzimin e mallrave/shërbimeve/punëve në vijim.

[*përshkrimi i përgjithshëm*]

1.2 Marrëveshja kuadër do të zbatohet me dërgimin e ftesave për ofertë tek operatorët ekonomikë, palë nëmarrëveshje.P.sh. kurdoherë që Autoriteti Kontraktor i përfshirë në këtë marreveshje, do të blejë artikuj në bazë të kësaj kontrate, duhet që të dërgojë "ftesën për ofertë" tek kontraktuesi, duke specifikuar listën me artikuj për furnizim me sasitë e tyre përkatëse.

1.3 Sasitë e parashikuara, janë vetëm sasi orientuese dhe nuk e kushtëzojnë Autoritetin Kontraktor për t'i blerë ato. Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të blejë më pak apo më shumë sasi se sa ato te parashikuara.

1.4 Kontraktuesi nuk do të ketë të drejtë kompensimi dhe nuk do t'i lejohet të bëjë ndryshime të çmimeve të njësisë, për shembull në rast se autoriteti kontraktor vendosë të blejë më pak apo

më shumë sasi se sa ato të specifikuara dhe/ose në rast se autoriteti kontraktor vendos të mos blejë asnjë nga këto sasi për disa artikuj.

1.5 Kohëzgjatja e marrëveshjes kuadër:

________________________

**Neni 2 Çmimi**

2.1 Çmimet për njësi për punë/mallra /shërbime janë treguar në Formularin e Cmimit të Ofertës.

2.2 Çmimet e njësive duhet të jenë fikse dhe nuk duhet t'i nënshtrohen ndryshimeve për porositë e vendosura në këtë marrëveshje kuadër.

**Nënshkrimet dhe Datat**

| **Për Kontraktuesin** | **Për Autoritetin Kontraktues** |
|---|---|
| **Emri:** | **Emri:** |
| Pozita: | Pozita: |
| Nënshkrimi: | Nënshkrimi<br>: |
| Data: | Data: |
| **Vula:** | **Vula:** |

**Shtojca 27**

## DRAFTI I MARRËVESHJES KUADËR

**( ku JO tË gjitha kushtet janË tË pËrcaktuara)**
**PËR PUNË / MALLRA / SHËRBIME**

**Emri i Autoritetit Kontraktor,**
Dhe

**Emri i Kontraktuesit**

Bien dakord si vijon:

**Të nënshkruajnë këtë marrëveshje kuadër për Kryerjen e:** < vendosni titullin >me numrin identifikues : <*vendosni Numrin e Prokurimit*>

**Neni 1 Objekti**

i Objekti i kësajmarreveshje kuadër është të vendosë rregullat për kontratat të cilat do të lidhen përmes procesit të mini-konkursit vetëm ndërmjet operatorëve ekonomike që janë palë e kësaj marrëveshje kuadër.

i Kjomarrëveshje kuadër nuk është një kontratë në vete por përcakton kushtet për kontratat që do të lidhen në bazë të saj.

i Kontraktuesi është vetëm një nga palët e marrëveshjes kuadër.

**Neni 2 Detyrimet e Palëve**

2.1 Autoriteti Kontraktues, palë në këtë marrëveshje, do t’i dërgojë kontraktuesit “Ftesën për Ofertë” kurdo që paraqitet nevoja për punë/mallra/shërbime.

i Kontraktuesi, detyrohet të dorëzojë një ofertë kurdo që kërkohet nga Autoriteti Kontraktor.

**Neni 3 Kontratat në zbatim të marrëveshjes kuadër**

3.1 Kontratat do të nenshkruhen vetëm pas procesit të mini-konkursit.

**Neni 4 Procesi i mini-konkurrencës**

4.1 Procesi i mini- konkursit do të kryhet me të gjithe operatorët ekonomikë, palë në marrëveshjen kuadër, kurdoherë që paraqitet nevoja për punë/mallra/shërbime për Autoritetet Kontraktore.

i Autoriteti Kontraktor do të ri-hapë konkursin në bazë të kushteve të njëjta ose të kushteve të tjera të vendosura në ftesën për ofertë, sipas përcaktimeve në dokumentat e tenderit.

4.3 Kurdoherë që paraqitet nevoja për punë/mall/shërbim Autoriteti Kontraktor duhet të përgatisë Ftesat për Oferte dhe t'ua dërgojë të gjithë operatorëve ekonomike, palë nëmarrëveshjen kuadër. Vlerësimi i ofertave do të bëhet sipas kritereve të përcaktuara në Ftesën për Ofertë

**Neni 5 Kohëzgjatja e marrëveshjes kuadër**

________________________________

**Nënshkrimet dhe datat**

| | |
|---|---|
| **Për Kontraktuesin** | **Për Autoritetin Kontraktues** |
| **Emri :** | **Emri:** |
| Pozita: | Pozita: |
| Nënshkrimi: | Nënshkrim: |
| Data: | Data: |
| **Vula:** | **Vula:** |